



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 138 prot.

Shkodër, më 25.03.2022

VENDIM

Nr. 79, datë 25.03.2022

"Për miratimin e Streategjive sektoriale në USH"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 38, pika 1, germa b; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa b, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 25.03.2022

Vendosi:

1. Të miratojë:
 - a. Strategjia e komunikimit dhe informimit publik (bashkëlidhur).
 - b. Strategjia e mësimdhënies (bashkëlidhur).
 - c. Strategjia e kërkimit shkencor (bashkëlidhur).
 - d. Strategjia e ndërkombëtarizimit. (bashkëlidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.







UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT DHE INFORMIMIT PUBLIK

(2022-2026)

LISTA E SHKURTIMEVE

BUSH – Biblioteka e Universitetit të Shkodrës
DBNJ – Dega e Burimeve Njerëzore
DF – Dega e Financës
DJ – Dega Juridike
DKKSHp – Dega e Kurrikulës, Kërkimit Shkencor dhe Projekteve
DMP – Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun
DZHMJ – Dega e Zhvillimit të Marrëdhënieve me Jashtë
IAL – Institucion i Arsimit të Lartë
NJQ - Njësia e Qendëruar Përgjegjëse
SA - Staf Administrativ
SCVS – Sigurimi i Cilësisë dhe Vendorsjes së Standardeve
UNISHK- Website Universiteti i Shkodrës
US - Unioni Studentor
USH – Universiteti i Shkodrës

1 VIZIONI DHE QËLLIMI

Strategjia e komunikimit dhe informimit publik është pjesë e rëndësishme e Strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Synimi i saj është të rregullojë dhe përmirësojë marrëdhëniet me publikun, përmes diversifikimit të mundësive për komunikim, shfrytëzimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit masiv bazuar jo vetëm në kërkesën për informim, por dhe nevojën për të krijuar një nivel bashkëkohor dhe konkurrues të Universitetit në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Komunikimi efektiv ndodhet, si në çdo sektor të jetës, në qendër të pothuajse çdo aspekti të veprimtarisë universitare, pasi ai lidh universitetin me të gjithë aktorët me të cilët bashkëvepron: staf akademik dhe administrativ, studentë, partnerë vendas dhe të huaj, institucione të pushtetit qendror e lokal, media, komunitet etj.

Politikat e komunikimit dhe informimit publik mbështesin vizionin e Strategjisë së Përgjithshme të Universitetit dhe Strategjive sektoriale, duke lehtësuar njohjen dhe zbatimin e tyre jo vetëm nga përfutuesit, por edhe nga partnerët tanë në përmbyshjen e objektivave strategjike. Në thelb, strategjia përbën një përpjekje për të çuar më tej komunikimin mes Universitetit dhe audiencës, komunitetit brenda dhe jashtë botës akademike, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, studentëve dhe qytetarëve, faktorizimin e tij, çfarë përbën edhe bërthamën rreth së cilës shijellohet plani i zhvillimit të saj.

Kjo strategji do të jetë një ndihmesë për përmirësimin e performancës së Universitetit dhe faktorizimin e tij duke rritur transparencën përmes ofrimit efektiv të informacionit, përmirësimit të mjeteve të komunikimit me qëllim përthithjen e mendimit nga brenda dhe nga jashtë institucionit për çështje që ndikojnë në rritjen e cilësisë së jetës akademike e intelektuale.

Vizioni ynë është: Universiteti i Shkodrës faktor në promovimin e dijës, shkencës dhe vlerave komunitare e intelektuale, mundësuar përmes komunikimit dhe informimit transparent.

2 PARIMET E REALIZIMIT TË STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT DHE INFORMIMIT PUBLIK

Realizimi i qëllimit strategjik i komunikimit dhe informimit publik bazohet në disa parime teorike dhe aspekte praktike, si:

- Parimi i balancimit të marrëdhënies mes USH-së dhe Audiencave të interesuara: informacioni dhe ndërveprimi i vazhdueshëm harmonizon kërkesën e USH-së për të konsoliduar prezantimin e vet si institucion arsimor dhe shkencor (USH në qendër) dhe kërkesat e përfutuesve dhe të grupeve të interesit të arsimit të lartë (audiencia në qendër);



- Komunikim i kombinuar: komunikim njëkahësh dhe komunikim simetrik dykahësh. Qarkullim i informacionit, nga marrësi tek dërguesi dhe anasjelltas duke mundësuar feedback;
- Parimi i komunikimit në rrjet dhe informimit ndërmjet të gjithë aktorëve brenda dhe jashtë USH-së që qarkullon: nga lart-poshtë, nga organet dhe autoritetet drejtuese të USH-së drejt njësite bazë; nga poshtë – lart, nga njësitë bazë tek organet dhe autoritetet drejtuese të USH-së; horizontalisht, ndërmjet departamenteve, apo departamenteve dhe njësite administrative; nga brenda - jashtë, nga organet dhe strukturat e universitetit drejt aktorëve të zhvillimit, IAL-ve vendase dhe të huaja, si dhe klientëve; nga jashtë-brenda duke iu përgjigjur tendencave, interesave dhe kërkesave për partneritete dhe shërbime;
- Parimi i faktorizimit: Universiteti është i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e tij sociale dhe e ushtron atë në jetën publike në mënyrë gjithnjë e më aktive. USH përdor një kuadër të përgjithshëm vlerash, standardesh, mjetesh për të transformuar zhvillimin e kapaciteteve njerëzore intelektuale në përfitime të qëndrueshme për të gjithë komunitetin.

3 PREZANTIMI I SITUATËS EKZISTUESE

Për të vlerësuar situatën ekzistuese të informimit dhe komunikimit me publikun nuk jemi bazuar në majten sasiore të treguesve, sepse Njësia përgjegjëse e parashikuar për këtë qëllim (Njësia e qendërzuar) nuk është krijuar, por jemi bazuar në të dhëna cilësore dhe sasiore, të mbledhura përmes pyetësorëve dhe burime dytësore të strukturave të universitetit, të anagazhuara me funksione specifike në marrëdhëniet me publikun.

3.1 VLERËSIMI I APLIKIMIT TË PARIMEVE TË ZBATURA SIPAS PLANIT TË AKTIVITETEVE.

Komunikimi i Universitetit me Publikun u vlerësua sipas realizimit të kuadrit strategjik të informimit dhe komunikimit. Sipas perceptimeve të strukturave përbërëse dhe individëve të USH-së, aktivitetet e parashikuara për t' u realizuar në funksion të arritjes së 3 objektivave rezultojnë si më poshtë:

- **Objektivi 1:** 44% të pazbatuara (ngritja e strukturave informuese në shkallë njësie bazë apo kryesore, komunikimi online me publikun përmes një hapësire të përcaktuar për këtë qëllim në website të USH-së që mbetet i centralizuar dhe pa akses për strukturat në varësi të Rektoratit, fushatat e informimit në institucione të arsimit parauniversitar, komunikimi me mediat sociale e vizive kërkohet të jetë më sistematik dhe sipas një strategjie të mirëmenduar, përfshirja edhe pse jo mjaftueshëm e përfaqësive studentore në procesin e informimit dhe komunikimit);
- **Objektivi 2:** 39% në zbatim e sipër (krijimi i adresave sipas organigramës, grupeve e komuniteteve me qëllime të përbashkëta; rritja e shkallës së digitalizimit; prania e specialistëve IT pranë çdo fakulteti, ngritja pjesërisht e strukturave informuese në shkallë universiteti);
- **Objektivi 3:** 17% të zbatuara (pasqyrim relativisht i gjerë e dinamik i të gjithë veprimtarisë së USH-së në website, por i centralizuar).

Nisur nga ky nivel realizueshmërie, ka vend për përmirësime të ndjeshme në komunikimin dhe informimin me publikun. Menaxhimi i marrëdhënieve me publikun mund të përmirësohet në nivel Rektorati, Fakulteti, Departamenti. Perceptohet përmirësim i dukshëm në komunikimin me audiencën e brendshme edhe pse duhet rregulluar duke respektuar nga njëra anë detyrimet për transparencë, nga ana tjetër, mbrojtjen e sigurisë së të dhënave personale. Komunikimi me audiencat e jashtme duhet intensifikuar. Përpjekje pozitive janë bërë për digitalizimin e procedurave administrative.

Është parashikuar ngritja e një strukture përgjegjëse për komunikimin me publikun, por nuk është realizuar, çfarë ka sjellë edhe këtë nivel të lartë pazbatueshmërie të veprimitarive të parashikuara për arritjen dhe realizimin e objektivave, misionit dhe qëllimit të kësaj strategjie. Përgjegjësitë për komunikimin kanë vazhduar të jenë të copëzuara dhe të deleguara strukturave të tilla, si: IT-së në USH, Rektoratit (pa specifikuar se kujt), drejtuesit e njëjësive kryesore ose bazë (dekani, drejtor departamenti), stafi akademik (anëtarët), asnjë.

Vlen të theksohet se situata e pandemisë Sars Covid 19 ka krijuar një klimë të favorshme për të krijuar struktura komunikuese më të qëndrueshme, pasi nxori në dukje të metat (të shumta), përparësitë dhe aftësitë e fituara nga zhvillimi i jetës akademike e shkencore online.

3.2 VLERËSIMI I AUDIENCAVE.

Lidhur me tipologjinë e audiencave me të cilat komunikohet opinionet janë të ndryshme, bazuar edhe në funksionet e strukturave që morën pjesë në vlerësim (fakulteti, departamenti, individi). Më të kuotuarit janë staf akademik dhe joakademik, studentët aktualë dhe potencialë, maturanët, IAL-të e tjera brenda vendit dhe jashtë tij, institucione të pushtetit qendror dhe lokal, organizata joqeveritare vendase dhe të huaja, përfaqësitë diplomatike dhe strukturat e tyre në vendin tonë, komuniteti i biznesit, komuniteti qytetar i rajonit të Shkodrës, punëdhënës privat e shtetëror në panairët e punës, agjencitë turistike të Rajonit.

3.3 VLERËSIMI I KANALEVE TË KOMUNIKIMIT.

Kanalet e përdorimit të gjerë në komunikimin e USH-së me publikun, në shkallë zbritëse u vlerësua se janë Web, rrjetet sociale, fushatat e informimit në prani fizike dhe online (në shkallë Fakulteti dhe departamenti), zyra e informimit për komunikimin e brendshëm, media e shkruar dhe audiovizive.

3.4 VLERËSIMI I STRUKTURËS ORGANIZATIVE.

Aktualisht në Universitetin e Shkodrës, si edhe katër vite më parë, nuk ka një njësi të qendëruar për komunikim me publikun. Janë disa struktura apo individë që e realizojnë këtë proces të rëndësishëm, si më poshtë:



Specialisti i komunikimit pranë zyrës së Rektorit, që komunikon informacione të ndryshme që lidhen me organizime, mbledhje dhe aktivitete të strukturave drejtuese të universitetit. Ai jep informacion përmes relacionesh të ndryshme për përmbajtjen e këtyre mbledhjeve.

Dega e Burimeve Njerëzore informon publikun e gjerë për të gjitha fazat e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës në Universitet. Konkretisht ajo informon përmes njoftimeve të hapjes së vendeve të punës, kritereve përkatëse, ankimmimeve dhe shpalljeve online dhe në media, mbikëqyr ecurinë e aplikimit online për pjesëmarrjen në konkurset për pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm.

Dega e Informacionit dhe e Teknologjisë mundëson shkëmbimin e informacioneve të ndryshme që kanë të bëjnë me mësimdhënien dhe vlerësimin, përmes portalit të pedagogëve dhe studentëve në faqen zyrtare elektronike të Universitetit. Kjo degë mundëson edhe shkëmbimin e informacionit elektronik me institucione të tjera të arsimit të lartë dhe me ministrinë. Kjo degë mbikëqyr rrjetin elektronik dhe sistemin.

Dega e Marrëdhënieve me Jashtë dhe e Zhvillimit informon publikun e gjerë për arritjet e universitetit përmes botimeve shkencore, broshurave, faqes zyrtare elektronike dhe mediave kombëtare e lokale. Në të gjitha këto hapësira publikohen veprimtaritë shkencore, konferencat, sesionet, seminarët e leksionet e hapura, promovimet, ekspozitat, veprimtaritë kulturore e sportive, veprimtaritë jubilarë, panairët, marrëveshjet, projektet, binjakëzimet, mobilitetet etj. Gjithashtu jep informacion të hollësishëm për publikun lidhur me projektet ndërkombëtarizuese të USH-së. Publikon marrëveshjet, memorandumet, kontratat e ndryshme me institucione homologe, vlerësimet e studentëve në gjuhët e huaja, mobilitetet e studentëve dhe stafit akademik apo ndihmës.

Sekretariatë e dekanëve dhe sekretariatë mësimore në fakultete japin informacione të ndryshme për studentët dhe komunitetin në lidhje me shumë çështje që kanë të bëjnë me rregullat, procedurat, procesin mësimor dhe veprimtaritë e ndryshme në funksion të studentëve e pedagogëve, më së shumti në ballafaqime individuale.

Konkluzion: mungon një qasje proaktive që e faktorizon USH-në në ndërveprim me aktorë të zhvillimit ekonomik, social e kulturor duke e bërë atë “të domosdoshëm” në platformat e politikave rajonale e kombëtare. Dega e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Zhvillimit do të duhet të fuqizojë qasjen proaktive (në koordinim me fakultetet) ose të ristrukturohet duke brendësuar edhe funksionet e Njësisë së Qendëruar. Digjitalizimi duhet shtrirë përtej procesve administrative duke mundësuar brandim më të mirë të USH-së përmes avantazheve që ofron teknologjia e informacionit.

4 INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI I USH-SË ME PUBLIKUN NË KATËR VITET E ARDHSHME.

Bazuar në të dhënat aktuale për informimin dhe komunikimin me publikun, si dhe në opinionet e shprehura lidhur me këtë proces në katër vitet e ardhshme, strategjia e informimit dhe komunikimit në zbatim të qëllimit dhe vizionit të identifikuar përmes një procesi pjesëmarrës, ka këto objektiva:

1. Përmirësimi i nivelit të komunikimit dhe informimit përmes zgjerimit të grupeve të audiencës me të cilat duhet të komunikojë USH dhe brandimi i pikave të forta (sipas fakulteteve).

Tipologjitë e aktiviteteve që do të përmirësonin nivelin e komunikimit, imazhin e raportit me publikun janë bazuar në:

- Intensifikimin e komunikimit brenda universitetit dhe normimin e tij përmes një rregulloreje të posaçme;
- Krijimin e strukturave informuese për çdo fakultet, për komunikimin me publikun dhe brandimi i pikave të forta të secilit fakultet;
- Transparençën në takimet që organizohen në fakultete dhe departamente, me qëllim qarkullimin e informacionit të gjithë stafëve të USH-së;
- Hapësirën më të gjerë për komunikimin online përmes një linku në faqen e USH-së për komunikim direkt me publikun për çdo fakultet;
- Decentralizimin e websiteve të USH-së për pasqyrimin e arritjeve, aktiviteteve shkencore e akademike, aplikime për punë, për bursa studimi etj.;
- Krijimit të *website* për çdo departament;
- Fushatat e informimit në institucione të arsimit parauniversitar, kombinuar me organizimin e “Ditëve të dyerve të hapura” në USH dhe ngjarjeve të përbashkëta për të nxitur përthithjen e studentëve të rinj përmes njohjes më të mirë të ofertës;
- Rritjen e komunikimit me mediat sociale e vizive përmes një strategjie të mirëmenduar;
- Përfshirjen e përfaqësive studentore në procesin e informimit dhe komunikimit;
- Zgjerimin e komunikimit me audiencën më larg vëmendjes së deritanishme duke krijuar rrjete tematike (përdorimi i teknologjisë), të tilla, si: ish-studentët (alumn-it) dhe pedagogë; organizatat jofitimprurëse me fokus projektet e zhvillimit rajonal; qendrat kërkimore brenda dhe jashtë vendit, universitete të tjera; shoqëria civile; rrjete advokuese dhe lobuese.

2. Funksionalizimi i komunikimit dhe informimit në të gjithë strukturën organizative të Universitetit përmes delegimit të përgjegjësisë për komunikimin me publikun.

Komunikimi, që të jetë efikas, duhet shtrirë në të gjitha hallkat e strukturës organizative të USH-së, prandaj synohet krijimi i një kulture të komunikimit dhe informimit publik në shkallë rektorati, fakulteti dhe departamenti, në drejtim vertikal dhe horizontal, dykahësh, mes stafit akademik dhe atij joakademik dhe atij joakademik, mes USH-së dhe audiencave jashtë tij.



Shpërndarja e përgjegjësisë për nivelin dhe format e komunikimit dhe informimit publik në USH risjell në vëmendjen domosdoshmërinë e delegimit të përgjegjësisë ndaj një strukture, posaçërisht e fokusuar tek kjo problematikë (shih konkluzionet më lart). Të anketuarit rishprehen në favor të krijimit të strukturës përgjegjëse për komunikimin dhe informimin e USH-së me publikun, që të ketë në përbërje të saj përfaqësues të çdo Fakulteti. Kjo strukturë do të mund të ishte Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, që do të koordinonte komunikimet sektoriale të realizuara nga Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, si dhe të gjitha strukturat e USH-së, nga Rektorati tek Departamenti. Në një skenar më pak të favorshëm, duhen sqaruar detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Zhvillimit në funksion të komunikimit ku personat përgjegjës duhen trajnuar me njohuritë bashkëkohore.

3. Alternimi dhe përparësia e kanaleve më efikase të komunikimit përmes monitorimit të vazhdueshëm.

Për të pasur një komunikim të shpejtë e të gjerë duhet alternuar produkti tradicional i Marrëdhënieve me Publikun (media, buletin, konferencat për shtyp, fletëpalosjet etj.) dhe dhënë përparësi kanaleve më efikase të komunikimit me audiencën, ato që janë lehtësisht dhe masivisht të aksesueshëm (websites, rrjetet sociale, fushatat informuese dhe sensibilizuese etj.). Komunikimi dhe informimi është një proces dinamik, i ndjeshëm ndaj ndryshimeve shoqërore, kësaj monitorimi i vazhdueshëm i mjedisit komunikativ nga Departamenti i MP do të mundësojë përputhshmërinë e politikave të Universitetit me tendencat më bashkëkohore.

Situata e krijuar nga gjendja e pandemisë mbarëbotërore, zhvillimi i procesit mësimor online, ka kapërcyer metodat tradicionale të komunikimit edhe mes aktorëve që kanë bazuar raportet e bashkëpunimit kryesisht mbi pranimë fizike (pedagog/student, konferenca, aktivitete shkencore e kulturore, realizime revistash e dokumentarësh), çfarë ka krijuar një klimë të favorshme për realizimin e një sere veprimtarish mësimore e kërkimore shkencore online edhe në kushte normaliteti. Në këtë mënyrë rritet prania dhe impakti i Universitetit nga pikëpamja gjeografike, sociale, administrative, përmes përfshirjes direkte ose indirekte edhe të audiencave e grupeve të interesit më të distancuara kundrejt qëllimit dhe vizionit të USH-së.

Propozohet që Senati të aprovojë një paketë treguesish të performancës mbi komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm të universitetit (referencë mund të jetë kjo strategji) dhe të bëjë monitorimin 3- mujor të tyre, duke marrë masa korrektuese në rast mosrealizimi. Treguesit duhet të synojnë nxitjen e faktorizimit të Universitetit dhe krijimin e një brand-i tërheqës për klientët dhe audiencat e interesuara duke shfrytëzuar kanale të ndryshme komunikimi dhe avantazhet teknologjike.

4. Faktorizimi i USH-së, rritja e ndjeshmërisë së tij ndaj interesave publike në mënyrë proaktive.

Nëse mësimdhënia është një detyrë me rëndësi themelore që siguron në mënyrë shteruese aftësitë bazë, duke transmetuar njohuri, është kërkimi shkencor ai që lejon prodhimin e njohurive, për t'i transferuar ato më pas si qëllim i të ashtuquajturit "faktorizim i universitetit". Vetëm përmes prodhimit të njohurive universiteti mund të realizojë plotësisht rolin e tij zhvillues në shoqëri. "Universiteti në qendër" është modeli i universitetit forcë lëvizëse e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, gjenerues i mundësive dhe

politikave të inovacionit përmes kërkimit shkencor. Një universitet që akumulon përherë e më shumë përgjegjësi shoqërore për të ndërhyrë aktivisht, si protagonist, në politikat e rritjes dhe fuqizimit të territorit ku vepron apo vendit të tij në tërësi. Një universitet që krijon dialog me shoqërinë. Ky vizion duhet të përthyer në plane pune të detajuara për secilin fakultet, financohet e monitorohet nga Senati. Qendrat dhe Institutet Kërkimore duhet të kthehen në motorë të faktorizimit. Dialogu i universitetit me shoqërinë që të jetë efikas kërkon që njohuritë e gjeneruara të shpërndahen në mënyrë efektive, por edhe krijimin dhe lehtësimin e platformave permanente të komunikimit sipas prioriteteve të USH-së.

4.1 KONCEPTI PËR TË ARDHMEN.

Për të realizuar një komunikim sa më të arrirë rishtrohet nevoja e krijimit të një njësie të qëndrueshme, përgjegjëse për komunikimin dhe informimin publik. Moskrijimi i saj shpjegohet edhe me faktorë subjektivë, siç ishin proceset e lëvizjes studentore në dhjetor të vitit 2018, fatkeqësitë natyrore (tërmeti dhe pandemia e Covid 19) në dy vitet në vijim, që ndryshuan stilin e funksionimit e jetës akademike e shkencore, por nga ana tjetër, edhe diktuan urgjencën e krijimit të saj si hallkë e domosdoshme në mbarëfunksionimin e universitetit në situata të papritura e të pazakonta. Ajo përmes informimit ushtron funksionin e saj mbi aktorët brenda sistemit të USH-së dhe jashtë tij përmes kanaleve të informimit njëkahësh dhe dykahësh. Për mirëfunksionimin e saj, njësia qendrore, delegon përgjegjësitë për komunikimin dhe informimin publik, sipas një drejtimi vertikal, fakulteteve, këta të fundit departamenteve, si dhe institucioneve mbështetëse të strukturave të USH-së, si: struktura e IT-së, e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, e Burimeve Njerëzore, struktura financiare etj. Njësia gjithashtu krijon mundësinë e ushtrimit të një trysnie dykahëshe nga qendra në bazë dhe anasjelltas për transparencë dhe llogaridhënie, për sipërmarrjen e përgjegjësiave sociale nga ana e USH-së. Njësia ushtron përmes komunikimit të jashtëm ndikimin e saj mbi aleatët e mundshëm të USH-së, të botës akademike dhe sociale e politikëbërëse, ndikon mbi konkurrentët potencialë të USH-së, si dhe shumëfishon impaktin e universitetit në jetën komunitare.




Fig. 1 Skema organizative e politikave të komunikimit dhe informimit të Universitetit e zbatuar përmes Njesisë së Qëndërzuar ose rishtimit të funksionit të Departamentit të Mardhënëve me Jashtë dhe Zhvillimit.

5 VIZIONI

Universiteti i Shkodrës, institucion i dijes, shkencës dhe vlerave komunitare e intelektuale mundësuar përmes komunikimit dhe informimit transparent.

6 QËLLIMI

MP në USH janë rregulluar dhe avancuar, përmes diversifikimit të mundësive për komunikim, shfrytëzimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit masiv bazuar jo vetëm në kërkesën për informim, por dhe nevojën për të krijuar një identitet konkurrues të Universitetit në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Përmeshja e qëllimit në funksion të MP do të matet një herë në vit përmes treguesve të tillë (niveli outcome):

Komunikimi i jashtëm:	Komunikimi i brendshëm:
(i) Nr. i aktorëve tek të cilët arrijmë. (ii) Nr. i konkurrentëve të kthyer në aleatë. (iii) Nr. i aktorëve me efekt multiplikues aktiv në komunikim. (iv) Nr. i rrjeteve që mbështesin prioritetet e USH-së dhe faktorizojnë atë. (v) Nr. i medive sociale ku jemi të pranishëm dhe komentet pozitive për USH-në. (vi) Kënaqësia e përfituesve (studentëve dhe aktorë zhvillimi). (vii) Brandimi i pikave të forta të çdo fakulteti: nr. i ngjarjeve/kanaleve përmes të cilave bëhet i njohur brand-i.	(i) Plane komunikimi ekiztojnë për çdo fakultet. (ii) Çdo fakultet është i pranishëm në Web dhe media sociale. (iii) Plani i transparencës së universitetit hartohet dhe monitorohet. (iv) Njësia e qendëruar e ndërtuar. (v) Rregullore për përdorimin e të dhënave personale. (vi) Plani i konsultimit me fakultetet për çështje të rëndësishme së veçantë aprovohet nga Senati. (vii) Kënaqësia e stafit.




7 PLANI I AKTIVITETEVE

Plani i aktiviteve për përbushjen e vizionit dhe qëllimit të Universitetit të SHKODRËS në funksion të Marrëdhënieve me Publikum është i organizuar rreth 4 objektivave kyçe, një paketë aktivitetesh që garanton përbushjen e tyre dhe treguesve të posaçëm të performancës për matjen e rezultateve të arritura. Treguesit në nivel objektivash (outputesh) janë zgjedhur qëllimisht të natyrës sasore ndonëse për matjen e tyre mund të përdoren edhe metoda cilësore (takime me fokus grupe, pyetësorë të hapur, intervista etj.) në funksion të arritjes së rekomandimeve për përmirësimin dhe verifikimit të rezultateve sasore. Me aprovimin e Strategjisë, njësia e qendërzuar do të ndërmarrë përcaktimin e base-line (në ato tregues ku është e nevojshme) dhe monitorimin vjetor të rezultateve të arritura. Treguesit në nivel outcome do të maten përmes dhe në fund të mandatit të të zgjedhurve të dilet me rekomandime për përmirësimet, objekt aprovimin nga strukturat drejtuese të Universitetit.



<p>Objektivi 1 <i>Përmirësimin e nivelit të komunikimit dhe informimit përmes zgjerimit të grupeve të audiencës me të cilat duhet të komunikojë USH dhe brandimi i pikave të forta (sipas fakulteteve).</i></p>	<p>Tregues performance në nivel output-i:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Studim mbi komunikimin dhe mundësitë për përmirësim; 2. Nr. i kanaleve të komunikimit dhe informimit; 3. Nr. fakultetesh që kanë krijuar brand-in e tyre dhe e promovojnë atë rregullisht; 4. Rregullore për informimin dhe komunikimin; 5. Nr. i fushatave informuese të ndërmarra; 6. Nr. i këkesvave të studentëve për info/komunimim të konsideruara dhe financuara; 7. Faqe web-i interaktive; 8. Kategoritë e audiencave që e ndjekin USH-në. 	<p>Metoda e majtes dhe verifikimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumente të hartuara 2. Faqja e internetit dhe Marrëveshje, certifikatë anëtarësimi etj.; 3. Databasa e pjesëmarrësve në aktivitete dhe/ose algoritme të medias sociale.
<p><i>Përshkrimi i aktiviteteve</i></p> <p>Studim mbi nivelin ekzistues të komunikimit dhe anketime mbi mënyrën e përmirësimit të tij.</p> <p>Fushata informuese periodike në institucione të arsimit parauniversitar, kombinuar me organizimin e “Ditët të dverve të hanura” në USH.</p>	<p><i>Përgjegjës</i></p> <p>Njësia e qendëruar përgjegjëse për komunikimin dhe informimin publik (NJQ) me strukturat varëse të saj.</p> <p>NJQ në bashkëpunim me fakultetet dhe strukturat mbështetëse, BUSH.</p>	<p><i>Shpjegime ose Shpenzim?</i></p> <p>Ky aktivitet shërbën për të rishikuar planin e propozuar.</p> <p>Kërkohej fond.</p>





<p>Krijimi i qendrave të dedikuara të informimit për studentë dhe materialeve mbështetëse (p.sh. fletëpalosje, broshura etj.).</p>	<p>NJQ, Unioni studentor (US), Fakultetet, etj...</p>	<p>Ky nivel komunikimi do të realizohet përmes ditëve të studimit, workshopëve tryezave të rrumbullakëta, pjesëmarrjeve në aktivitete të ndryshme të organizuara nga aktorë të jashtëm lokalë. Kërkohej fond.</p>
<p>Intensifikim i komunikimit brenda universitetit dhe normimi i tij përmes një rregulloreje të posaçme.</p>	<p>Senati NJQ</p>	<p>Komunikimi duhet rregulluar përmes një rregulloreje.</p>
<p>Përcaktimi i Brand-it të çdo Fakulteti.</p>	<p>Fakultet NJQ ICT</p>	<p>Fakultetet duhet të identifikojnë dhe promovojnë pikat e tyre të forta në mënyrë miqësore dhe dinamike</p>
<p>Hapësirë më e gjerë për komunikimin online përmes një linku në faqen e USH-së për komunikim direkt me publikun për çdo fakultet.</p>	<p>ICT NJQ Fakultet</p>	<p>Dhënia e feedbackut mundëson besueshmëri. Mund të kërkohej ridizenjimi i faqes web për të mudësuar interaktivitetin.</p>
<p>Përfshirja e përfaqësive studentore në procesin e informimit dhe komunikimit.</p>	<p>NJQ Unioni Studentor</p>	<p>Kërkohej të kuptohen nevojat e tyre, por edhe kontributi që mund të ofrojnë.</p>
<p>Zgjerimi i komunikimit me audiencën më larg vëmendjes së deritanishme duke krijuar rrjete tematike (përdorimi i teknologjisë) të tilla, si: ish-studentët (alumn-it) dhe pedagogë; organizatat jofitimprurëse me fokus projektet e zhvillimit rajonal; qendrat kërkimore brenda dhe jashtë vendit, universitete të tjera; shoqëria civile; rrjete advokuese dhe lobuese.</p>	<p>NJQ Fakultet</p>	<p>Hartimi i studimit (shih më lart) për t'i përcaktuar këto audiencë është i nevojshëm.</p>
<p>Të tjera për t'u identifikuar nga Njësia e Qendëruar.</p>		
<p>Objektivi 2 <i>Funksionalizimi i komunikimit dhe informimit në të gjithë strukturën</i></p>	<p>Tregues performance në nivel output-i: 1. Nr. i kanaleve për komunikimin dhe</p>	<p>Metoda e matjes dhe verifikimi: 1. Rregullore dhe vendime për krijimin e kanaleve;</p>



<p><i>organizative të Universitetit përmes delegimit të përgjegjësiave për komunikimin me publikun.</i></p>	<p>informimin e brendshëm dhe vendimet të marra në funksion të përmirësimit të komunikimit dhe informimit të brendshëm;</p> <p>2. 1 Njësi strukturore e krijuar me dokumentacionin përkatës;</p> <p>3. Nr. i ndryshimeve në statut, rregullore etj., në funksion të komunikimit dhe informimit të përmirësuar (për aspekte të sigurisë së të dhënave).</p>	<p>2. Vendimi për ngritjen e Njësisë strukturore (përshkrimi i punës, struktura organizative, rolet dhe përgjegjësitë);</p> <p>3. Rregulloret e universitetit, statuti etj.;</p> <p>4. Evidenca faktike.</p>
<p><i>Përshkrimi i aktiviteteve</i></p> <p>Përmirësimi i elementëve të komunikimit të brendshëm institucional, përmes garantimit të përcimit të informacioneve dhe mendimeve horizontalisht dhe vertikalisht (p.sh. publikimi i projekteve që kalojnë në Senat apo Bord përpara se të merren vendimet) i rregulluar sipas normave e standardeve të nevojshme.</p>	<p><i>Përgjegjës</i></p> <p>Rektorati Fakulteti Departamenti Senati</p>	<p><i>Shpjegime ose Shpenzime</i></p> <p>Konsiston në përcjelljen e informacionit, në kohë, nga strukturat më të larta vendimmarrëse për Institucionin deri në bazë dhe anasjelltas. Është e rëndësishme marrja e një feedback përmes komunikimit dykahësh.</p>
<p>Rritja e efikasitetit të komunikimit përmes maksimizimit të përdorimit të instrumenteve teknologjike në dispozicion (Office 365 me të gjithë komponentët) dhe trajnimin të stafave për përdorimin e tyre.</p>	<p>SA Stafi administrativ (DBNJ, DF, DJ, DMJ, IT, DKSH) US apo organizimet alternative studentore</p>	<p>Angazhimi i strukturës IT për dhënien e asistencës së nevojshme për SA, stafin administrativ në përdorimin e burimeve teknologjike.</p>
<p>Krijimi i njësisë qendëruese për komunikimin dhe informimin publik.</p>	<p>Rektorati</p>	<p>Në varësi të kompetencave, emërohet njëjësia dhe përgatitet rregullorja e funksionimit.</p>
<p>Hartimi dhe zbatimi i planit të konsultimit me studentët/fakultet dhe transparencës.</p>	<p>NJQ Senati</p>	<p>Respektimi i detyrimeve për informim, konsultim dhe transparencë që buron nga kuadri ligjor.</p>
<p>Zgjedhja e një person kontakti për informimin dhe komunikimin publik për</p>	<p>Departamenti Administrata</p>	<p>Fakultetet përcaktojnë personin e kontaktit pranë fakultetit.</p>

<p>çdo departament, për administratën dhe për unionin studentor .</p> <p>Të tjera për t'u identifikuar nga Njësia e Qendëruar</p>	<p>US</p>	<p>Personat e kontaktit ndërveprojnë ngushtësisht me NJQ.</p>
<p>Objektivi 3: <i>Alternimi dhe përparësia e kanaleve më efikase të komunikimit përmes monitorimit të vazhdueshëm.</i></p>	<p>Tregues performance në nivel output-i:</p> <ol style="list-style-type: none"> Nr. i tematikave të trajtuara në proceset e informimit dhe komunikimit; Nr. i inovacioneve të mbështetura dhe të zhvilluara në fushën e komunikimit dhe informimit universitar; Nr. i ndryshimeve të ndërmarra si rezultat i transparencës dhe llogaridhënies në universitet. 	<p>Metoda e majtes dhe verifikimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> Monitorim përmbajtësor (jo vetëm statistikor) të gjitha sistemeve të informimit dhe komunikimit të instaluara në universitet; Vendime, udhëzime, rregullore.
<p><i>Përshkrimi i aktiviteteve</i></p>	<p><i>Përgjegjës</i></p>	<p><i>Shpjegime ose Shpenzime</i></p>
<p>Përmirësimi dhe rritja e efikasitetit të kanaleve ekzistues të komunikimit.</p>	<p>NJQ IT Departamenti dhe Fakulteti</p>	<p>Web-i i Universitetit mund të jetë interaktiv. Krijimi i grupeve tematike/kërkimore në whatsapp.</p>
<p>Evidentimi i kanaleve alternative të komunikimit.</p>	<p>NJQ</p>	<p>Diversifikimi i kanaleve mundëson arritje tek një spektër më i gjerë ndjekësish: media sociale dhe media tradicionale.</p>
<p>Pasqyrimi i aktiviteteve akademike dhe sociale në nivel departamenti, fakulteti, por edhe ndërveprimi të USH-së me aktorë të tjerë kyç të zhvillimit.</p>	<p>ICT</p>	<p>Kjo mundësohet falë aktivizimit të faqes online për departamentet dhe fakultetet, që nuk janë mjaftueshëm funksionale. Nuk kërkon fonde veç shpenzimeve të pagave dhe rishikimit të përshkrimeve të punës.</p>
<p>Konferenca për shtyp të rregullta me median mbi inovacionin dhe risitë në universitet.</p>	<p>NJQ</p>	<p>Nuk kërkon fonde veç shpenzimeve të pagave dhe rishikimit të përshkrimeve të punës.</p>
<p>Monitorimi i rregullt dhe korrektimi i</p>	<p>NJQ</p>	<p>Propozohet një listë treguesish</p>



<p>qasjeve ndaj kanaleve të komunikimit.</p>	<p>performance që monitorohet në mënyrë të vazhdueshme dhe varësisht rezultatit riprioritarizon kanalet e komunikimit.</p>	
<p>Të tjera për t'u identifikuar nga Njësia e Qendëruar</p>		
<p>Objekti 4: <i>Faktorizimi i USH-së, rritja e ndjeshmërisë së tij ndaj interesave publike në mënyrë proaktive.</i></p>	<p>Tregues performance në nivel output-i:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i çështjeve në shërbim të zhvillimit dhe të mirës publike që ka bërë publike universiteti në platforma të ndryshme; 2. Nr. i kërkesave për bashkëpunim me universitetin nga institucionet publike vendore, kombëtare e ndërkombëtare; 3. Numri i vendimmarrjeve ndërinstitucionale ku ka kontribuar universiteti të cilat i janë bërë të njohura publikut; 4. Nr. i përfaqësuesve të universitetit në borde e organe vendimmarrëse të bizneseve e aktorëve lokalë / rajonalë/kombëtarë. 	<p>1. Dokumentimi i publikimeve (arkiva dëgjiale);</p> <p>2. Kërkesa dhe procesverbale të protokolluara.</p>
<p><i>Përshkrimi i aktiviteteve</i></p>	<p><i>Përgjegjës</i></p>	<p><i>Shpjegime ose Shpenzime</i></p>
<p>Transferimi i njohurive të gjeneruara në universitetet përmes kërkimit shkencor në entitete publike dhe private (në koordinim të ngushtë me median).</p>	<p>Rektorati Fakultetet Departamentet NJQ</p>	<p>Fonde për kërkim shkencor. Mbështetje për promovim në media e platforma elektronike të gjetjeve shkencore.</p>
<p>Krijimi dhe promovimi i një portofoli aktiviteteve social-kulturore të përbashkëta me komunitetin dhe grupe profesionistësh e institucionesh që përfaqëjnë prioritetet e USH-së.</p>	<p>Rektorati Fakultetet Departamentet NJQ</p>	<p>Ky lloj komunikimi gjeneron në publik kuptimin për shkencën dhe për atë se çfarë është "angazhimi publik", duke e bërë komunitetin të vetëdijshëm, domethënë një komponent aktiv dhe pjesëmarrës në</p>




<p>Edukimi dhe trajnimi i vazhdueshëm për çështjet komunitare dhe me ndërveprim të fortë me shkollat e nivelit parauniversitar, aftësia për të krijuar rrjete bashkëpunimi midis institucioneve të ndryshme apo edhe midis disiplinave të ndryshme.</p>		<p>fushën e inovacionit. Fonde për bashkëfinancimin e portofolit të aktiviteteve.</p>
<p>Përfshirja në bordet e universitetit të aktorëve lokalë dhe biznesit për promovimin e tyre dhe të studentëve të USH-së të punësuar në këto biznese.</p>	<p>Rektorati Fakultetet Departamentet NJQ</p>	<p>Projektet e financuara nga organizma ndërkombëtarë që kërkojnë bazë të gjerë bashkëpunimi janë një terren i favorshëm që mundëson dialogun mes dijes (universitetit) dhe shoqërisë.</p>
<p>Organizimi i ditëve/javëve të kulturës së vendeve të ndryshme, festimi i festave kombëtare të shteteve në partneritet të ngushtë.</p>	<p>NJQ</p>	
<p>Anëtarësimi i vazhdueshëm në rrjete universitare, qendra dhe institute kërkimore, shqiptare dhe të huaja, dhe promovimi i tyre përmes ditëve të informimit.</p>	<p>NJQ në bashkëpunim me DKSH & DZHMJ</p>	<p>Komunikimi me këtë lloj audience pasuron informacionin për partnerët ndërkombëtarë si dhe lehtëson praktikatat e bashkëpunimit me ato.</p>
<p>Të tjera për t'u identifikuar nga Njësia e Qendëruar.</p>	<p>NJQ në bashkëpunim me DZHMJ & SKSHP dhe SCVS & BUSH</p>	<p>Ky lloj komunikimi mundëson projekte të përbashkëta, si edhe mobilitetin e studentëve brenda universiteteve shqiptare dhe atyre të huaja. Tarifë anëtarësimi.</p>

Grupi i punës

Alma Hafizi

Anila Dizdari

Valbona Karakaçi



Gasper Kokaj

¹ Njësia përgjegjëse do të duhej të mundësoje monitorimin sistematik të Strategjisë.

² Plani i aktiviteteve është vetëm orientues/tipologjik. Njësia e qendrësuar në bashkëpunim me administratën do të vlerësojë strategjinë.

PUBLIKI SHQIPËR
INSTITUTI I GI



UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES 2022-2026

Mars, 2022

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Prezantim i situatës aktuale.....	4
Qëllimi dhe objektivat.....	5
Plani i veprimit.....	6
Referenca.....	10
Grupi i punës.....	10



Shkurtime

ASCAL - Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë.

USH - Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

SA - Senati Akademik.

BA - Bordi i Administrimit.

Hyrje

Universiteti i Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, me një përvojë të gjatë 62- vjeçare, gjatë gjithë rrugëtimit të tij ka bërë përpjekje të vazhdueshme për përgatitjen dhe formimin cilësor të studentëve, duke i pajisur me njohuritë më bashkëkohore, me qëllim aftësimin e tyre për të demonstruar kompetenca teorike dhe praktike në fushat përkatëse të punësimit.

Strategjia e Mësimdhënies 2022-2026 synon të japë një përshkrim të plotë të përvojës së mësimdhënies në USH, duke pasqyruar situatën aktuale dhe duke bërë parashikimet për vitet në vazhdim, përmes përcaktimit të qëllimeve strategjike.

Parimet mbi të cilat është hartuar Strategjia janë: cilësia, etika, ndershmëria akademike, liria akademike.

Strategjia bazohet tek:

- Ligji Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, 2017-2021.
- Strategjia e Mësimdhënies e USH-së, Mars, 2017.
- Statuti i USH-së, miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr.366, datë 05.07.2018 “Për miratimin e Statutit të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër”.
- Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL).
- Vendim nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”.
- Vendim Nr.385, datë 17.12.2021 “Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore të USH-së për vitin akademik 2020-2021”.

Prezantim i situatës aktuale

Misioni i Universitetit të Shkodrës është krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transmetimi i dijeve me anën e mësimdhënies mbështetur në Deklaratën e Bolonjës dhe të punës kërkimore-shkencore, formimi i specialistëve të lartë dhe përgatitja e shkencëtarëve të rinj.

Mësimdhënia në Universitetin e Shkodrës:

- Mundëson formimin e njohurive të përgjithshme shkencore dhe profesionale të studentëve në fushën e tyre të studimit.
- Realizohet nëpërmjet programeve të studimit që respektojnë kërkesat dhe standardet e vlerësimit të Marrëveshjes së Bolonjës:



per të arritur nivelet evropiane të Arsimit të Lartë,

- për të siguruar transparencë të kualifikimeve universitare,
 - për të lehtësuar njohjen e diplomave,
 - për të mundësuar lëvizjen e studentëve nëpërmjet njohjes së rezultateve në nivel universitar dhe pasuniversitar.
- Realizohet sipas standardeve bashkëkohore dhe metodave të larmishme duke iu përshtatur jo vetëm profilit të lëndës, por edhe lirisë akademike të stafit akademik.
 - Realizohet nga një staf i kualifikuar, me tituj e grada shkencore të fituara brenda dhe jashtë vendit, me eksperiencë mësimdhënieje brenda dhe jashtë vendit si dhe nga një staf i ri në moshë, energjik, krijues dhe shumë i motivuar.
 - Plotësohet me eksperiencën e pedagogëve nga IAL-të perëndimore, pedagogëve të Universitetit të Tiranës apo pedagogë nga IAL-të e tjera të vendit.
 - Realizon aftësimin e studentëve në teknikat dhe strategjitë e komunikimit (ndër)kulturore.
 - Përafrohet me atë të universiteteve perëndimore gjë që krijon mundësi për shumë studentë të zhvillojnë studime semestrale në këto universitete në kuadër të projekteve të ndryshme.
 - Mbështetet në literaturë bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.
 - Mbështetet në teknologjinë e përparuar informatike dhe mundëson aksesimin në biblioteka dhe arkiva online.
 - Realizohet në auditorë sipas veçorive të lëndës dhe kushteve specifike.
 - Mbështetet në bashkëpunimin gjithnjë e në rritje me institucionet publike dhe private të rajonit të veriut.

Qëllimi dhe objektivat


Qëllimet dhe objektivat kryesore të mësimdhënies në USH për vitet 2022-2026 konsistojnë në:

- përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies me qëllim arritjen e standardeve më të larta,
- aplikimin e standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit,
- modernizimin e infrastrukturës,
- përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për studentët dhe
- rritjen e bashkëpunimit me komunitetin.

Plani i veprimit

Objektivi 1: Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, me qëllim arritjen e standardeve më të larta.

Nr.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Masat	Përgjegjës	Afati kohor
1	Promovim i kualifikimit të vazhdueshëm të stafit të brendshëm akademik përmes fitimit të titujve akademikë .	Mbështetje financiare nga institucioni.	Rritje e rolit të vendimmarrjes.	Rektorati SA BA	Vazhdimisht
2	Pajisja e bibliotekës së USH-së me literaturën e përditësuar.	Përfitim i një sasive librash të fushës. Sigurim aksesi në biblioteka online.	Pjesëmarrje në projekte. Nënshkrim marrëveshjesh bashkëpunimi.	Departamentet Rektorati	Vazhdimisht
3	Zbatimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies.	Trajnimi i stafit akademik.	Organizimi i workshopeve.	Departamentet dhe Zyra e Ekselencës	Çdo vit
4	Përmirësimi i sylabuseve të lëndëve.	Rishikim i përmbajtjes dhe i literaturës.	Diskutimi në departament.	Përgjegjësit e departamenteve	Në prag të fillimit të vitit akademik
5	Hapja e programeve të reja me karakter profesional, programeve të ciklit të dytë dhe programeve të ciklit të tretë, në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	Diskutim në departamente.	Aplikimi	Departamentet	Çdo vit
6	Zhvillimi i praktikave mësimore.	Rishikim i ngarkesës që ka praktika në planin mësimor të programeve të studimit.	Monitorim i ecurisë.	Përgjegjësit e departamenteve	Vazhdimisht
7	Punësimi i stafit akademik me kohë të plotë.	Rekrutim stafi, me qëllim sigurimin e raportit të	Hapja e konkurseve të pranimit.	Departamentet	Në varësi të nevojave



		drejtë student-pedagog .			
8	Përmirësimi i infrastrukturës dhe IT-së.	Krijim dhe përmirësim i laboratorëve.	Financim nga ana ekonomike.	Departamentet dhe Rektorati	Vazhdimisht
9	Përmirësimi i angazhimit të studentëve në punë kërkimore-shkencore.	Raportim në mbledhje të veçantë.	Angazhim i studentëve në kryerjen e projekteve kërkimore në bashkëpunim me pedagogët.	Pedagogët	Çdo vit

Objektivi 2: Aplikimi i standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit.

Nr.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Masat	Përgjegjës	Afati kohor
1	Akreditimi i programeve të studimit.	Diskutim në departamente.	Aplikimi	Departamentet, Dekanati, Rektorati Njësitë e sigurimit cilësisë	Vazhdimisht
2	Akreditimi institucional.	Krijimi i grupit të punës.	Aplikimi	Rektorati Njësitë e sigurimit cilësisë	Viti 2024
3	Hartimi i paketës së instrumenteve për sigurimin e cilësisë së USH-së.	Krijimi i grupit të punës.	Vendimmarje në SA.	Senati Akademik	Viti 2023
4	Përmirësimi i punës së Komisionit të Cilësisë në nivel fakulteti.	Hartim i rregullores së Komisionit (për secilin fakultet). Rishikim i përbërjes së Komisionit.	Monitorim i punës.	Dekanati	Vazhdimisht

Objektivi 3: Modernizimi i infrastrukturës

Nr.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Masat	Përgjegjës	Afati kohor
1	Përmirësim i infrastrukturës akademike të godinave, bibliotekës, laboratorëve dhe sallave të leksioneve duke i pajisur me logjistikën dhe mjetet e nevojshme teknologjike.	Ndërhyrjet përkatëse në ambientet në nevojë.	Parashikime në projektbuxhet.	Departamentet SA BA	Vazhdimisht
2	Përmirësim i infrastrukturës fizike për studentët me aftësi të kufizuara.	Përmirësimi i legjislacionit. Përmirësimi i mjediseve fizike.	Rishikim i rregulloreve të fakultetit dhe të departamenteve. Pajisja e ndërtesave me rampa të reja dhe me ashensorë.	Dekanatet SA BA	Vazhdimisht
3	Përmirësim i infrastrukturës akademike për studentët me nevoja të veçanta	Përmirësimi i legjislacionit.	Pajisja e USH-së me laboratorin përkatës .	Projekti IDEA	Në vazhdim
4	Sigurimi i mjediseve të përshtatshme pune dhe kushteve optimale për stafin akademik.	Ndërhyrjet përkatëse në ambientet në nevojë.	Parashikime në projektbuxhet.	Departamentet SA BA	Vazhdimisht

Objektivi 4: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për studentët

Nr.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Masat	Përgjegjës	Afati kohor
1	Rritje e bashkëpunimit pedagog-student përmes përfshirjes së tyre në aktivitete shkencore, sensibilizuese, sociale, kulturore dhe sportive.	Konferenca Realizim mini-projektsh Ekspozita Kampionate .	Parashikime në plan strategjike të fakulteteve. Parashikime në buxhet.	Departamentet SA BA	Vazhdimisht



2	Ofrimi i formave të ndryshme financiare me qëllim përmirësimin e statusit socio-ekonomik të studentëve.	Aplikime nga studentët.	Vazhdimisht	BA	Vazhdimisht
3	Rritja e mundësive të punësimit të studentëve tanë duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse.	Organizim i panairit. Organizim i tryezave të rumbullakëta.	Nënshkrim marrëveshjesh bashkëpunimi.	Departamentet Rektorati	Vazhdimisht
4	Përmirësim i mënyrës së tërheqjes së mendimit të studentëve lidhur me performancën e pedagogëve në mësimdhënie.	Hartimi i paketës së instrumenteve për sigurimin e cilësisë së USH-së.	Krijimi i grupit të punës.	SA	
5	Motivimi i studentëve për të marrë pjesë në Programin Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore.	Organizimi i takimeve me studentët.	Dhënie e informacionit në formën e njoftimeve.	Rektorati	Vazhdimisht

Objektivi 5 : Rritja e bashkëpunimit me komunitetin.

Nr.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Masat	Përgjegjës	Afati kohor
1	Zgjerim i bashkëpunimit me njësi publike dhe private që punësojnë të diplomuarit tanë, me qëllim që programet tona të plotësojnë nevojat profesionale.	-Zhvillimi i praktikave profesionale në institucione të ndryshme, në varësi të specifikave të programeve studimit. -Shkëmbim i ndërsjelltë i përvojës.	Nënshkrim marrëveshjesh bashkëpunimi. Zhvillim i tryezave të rumbullakëta, sesioneve shkencore.	Departamentet	Vazhdimisht
2	Ofrim i konsulencës profesionale (didaktike, psiko-sociale, sportive dhe artistike) për palët e interesuara.	Sensibilizim i komunitetit lidhur me potencialet akademike të stafit.	Kryerje e shërbimeve të ndryshme mjekësore, ligjore, psiko-sociale etj.	Departamentet	Vazhdimisht

3	Tërheqja e figurave të shquara drejt fakultetit.	Dhënia e mendimeve në përmirësim të mësimdhënies në lëndë specifike.	-Organizimi i orëve të hapura me studentët. -Pjesëmarrje si ekspertë të jashtë në GVB-të për çdo program studimi dhe në Komisionin e Cilësisë në nivel fakulteti.	Departamentet & Dekanati	Vazhdimisht
4	Rritje e vullnetarizmit nga ana e studentëve.	Zhvillimi i një plani paraprak me institucionet përkatëse.	Dhënie e certifikatave për studentët.	Departamentet	Vazhdimisht

Referenca

- Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, 2017-2021.
- Strategjia e Mësimdhënies së USH-së, Mars, 2017.
- Statuti i USH-së, miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr.366, datë 05.07.2018 “Për miratimin e Statutit të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër”.
- Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL).
- Vendim nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”.
- Vendim Nr.385, datë 17.12.2021 “Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore të USH-së për vitin akademik 2020-2021”.

Grupi i punës

Prof.as.dr.Arben Prendi

Prof.dr.Artan Haxhi

Prof.as.dr.Fatbardha Osmanaga

Prof.dr.Rajmonda Këçira

Dr.Pranvera Kraja



UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”



Strategjia e kërkimit shkencor në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Tabela dhe figura

Shkurtime

PJESA I- BACKGROUND DHE KONTEKSTI STRATEGJIK Error! Bookmark not defined.

1.Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik	8
2. Metodologjia	
3. Kuadri ligjor	
3.1. Kuadri i politikave	
3.2. Kuadri institucional	
4. Struktura e Universitetit	
4.1. Situata aktuale dhe analiza e situatës	
4.2. Sfidat dhe potencialet në kuadër të strategjisë	
4.3. Gjithëpërfshirja dhe balanca gjinore në kërkimin shkencor	
5. Analizë e faktorëve politikë, ekonomik-socialë dhe financiarë	
5.1. Analizë e faktorëve politikë, ekonomik-socialë	
5.2. Analizë e faktorëve teknologjikë dhe digjitalizimi	
5.3. Integriteti dhe transparenca gjatë kërkimit shkencor	
5.4 Nderkombëtarizimi i kërkimit shkencor	



5.5. Financimi i kërkimit shkencor

6. Vizioni dhe treguesit e ndikimit të strategjisë

6.1. Vizioni i strategjisë

6.2 .Treguesit e ndikimit të strategjisë.....

PJESA E DYTË QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

1. Objektivat

1.1 Objektivat afatshkurtër

1.2 Objektivat afatmesme.....

1.3 Objektivat afatgjatë

2. Objektivat specifike.....

2.1 Objektivat specifik1. Rritja e cilësisë së kërkimit

2.2 Objektivi specifik 2. Përsosmëria në kërkim e lidhja me mësimdhënien

2.3 Objektivi specifik 3. Lidhja me tregun e punës

2.4 Objektivi specifik 4. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor

2.5 Objektivi specifik 5. Integriteti dhe transparenca

2.6 Objektivi specifik 6. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor

2.7 Objektivi specifik 7. Shërbimet digjitale në funksion të kërkimit shkencor.....

PJESA E TRETË ZBATIMI I STRATEGJISË DHE PERGJEGJËSIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

3. Zbatimi i strategjisë së kërkimit shkencor

3.1 Monitorimi dhe raportimi

3.2 Vlerësimi

3.3 Plani i veprimit dhe burimet financiare

Aneks 1. Vizioni dhe objektivat të përmblodhur

Aneks 2. Plan veprimi i përmblodhur

Aneks 3. Formatit të planit të veprimit me analizën e kostos

Referencat



PJESA I- BACKGROUND DHE KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është një institucion i arsimit të lartë, i cili ka si mision të sigurojë arsimim, kërkim shkencor, zhvillim dhe transferim të njohurive dhe të teknologjisë. Kërkimi shkencor dhe mësimdhënia janë dy prioritetet kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të çdo institucioni të arsimit të lartë. Kërkimi shkencor duhet të jetë jo vetëm kontribuesi më aktiv dhe i vazhdueshëm i zhvillimit të institucioneve arsimore, por i të gjithë shoqërisë dhe në të gjitha fushat e saj. Çdo universitet ka si objektiv dhe detyrim procesin mësimor edhe kërkimin shkencor. Procesi i hartimit të strategjisë, i mbështetur nga asistenca dhe konsultimet e stafit akademik dhe atij drejtues, ka reflektuar rekomandimin e BE-së për të realizuar analiza të qëndrueshme dhe të konsoliduara të bazuara në evidenca, si elemente kyç për diskutime politikash të kërkimit shkencor të cilat janë në koherencë me zhvillimin e të gjitha politikave në fushën e arsimit të lartë dhe aftësimin. Hartimi i saj ka kaluar në një proces diskutimi dhe planifikimi duke e cilësuar atë si një dokument i cili do të kontribojë në arritjen e një shkalle të lartë të pajtueshmërisë me të gjitha prioritetet strategjike të USH-së dhe mënyrat për trajtimin e tyre. Procesi i planifikimit është organizuar në 5 faza:

- 1) Faza përgatitore** ku janë zhvilluar konsultime paraprake për metodologjinë e punës dhe formatin e strategjisë, si dhe janë formuar grupet e punës për hartimin e Strategjisë;
- 2) Analiza e situatës**, e cila ka rezultuar me identifikimin e problemeve kryesore në fushën e arsimit të lartë që do të trajtohen nga Strategjia;
- 3) Përcaktimi i objektivave dhe veprimtarive kryesore të Strategjisë së kërkimit shkencor;**
- 4) Kostimi i Strategjisë dhe hartimi i planit të zbatimit;**
- 5) Konsultimi me stafin akademik dhe atë ndihmës akademik, si dhe finalizimi i dokumentit.**

Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë objektivat afatmesme dhe afatgjata të USH-së për kërkimin shkencor me qëllim përmbushjen e misionit dhe vizionit që ka institucioni ynë si institucion pararojë në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në të gjithë Rajonin Verior. Ai synon të përmbushë objektivat që i kanë vënë vetes stafet akademike, ndihmës akademike dhe ato drejtuese, objektivat e studentëve në fushën e kërkimit dhe inovacionit, zhvillimin dhe kërkimin për praktikatat më bashkëkohore dhe inovacionin në shërbim të zhvillimit ekonomik e vlerave të kërkuara.

Në aspektin e integrimit në BE, Strategjia e Kërkimit Shkencor të USH-së 2022-2026 është në koherencë të plotë me katër objektiva strategjike të kornizës së Edukimit dhe trajnimit si bashkëpunim midis vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit dhe të formimit: forcimi i mobiliteteve, përmirësimi i cilësisë, nxitja e barazisë gjinore në kërkim, kohezioni social dhe qytetaria aktive si dhe rritja e krijimtarisë dhe sipërmarrjes, inovacionit, në të gjitha drejtimet e kërkimit. Gjithashtu kjo strategji është në harmoni me Kuadrin e ri të BE-së për kërkimin shkencor dhe inovacionin dhe objektivat e agjendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm. Ajo lidhet ngusht me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të arsimit si dhe me Strategjinë e Zhvillimit të USH-së.

2. Metodologjia

Si hap i parë drejt zhvillimit të Strategjisë së Kërkimit Shkencor në USH ka qenë krijimi i grupit të punës për hartimin e Strategjisë së Kërkimit Shkencor, i cili është mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga stafi drejtues, ai akademik dhe ndihmës akademik dhe studentët me sugjerime dhe vërejtje, me synim hartimin e një dokumenti të vlefshëm dhe praktik.

Procesi i planifikimit është organizuar në pesë faza:

Faza 1 – Faza përgatitore. -Gjatë kësaj faze, është krijuar grupi i punës, janë zhvilluar konsultime paraprake për metodologjinë e punës dhe formatin e Strategjisë së Kërkimit Shkencor, është përcaktuar përmbajtja, tematikat e Strategjisë dhe plani për hartimin e saj;

Faza 2 – Analiza e situatës. -Kjo fazë ka filluar me analizën e politikave të kërkimit shkencor dhe legjislacionit kombëtar, raporteve dhe studimeve që kanë ofruar informacionin e nevojshëm për situatën në sektorin e Arsimit të Lartë dhe kërkimit shkencor. Janë shfrytëzuar dokumente e strategji të zhvillimit, statistika kombëtare dhe ato të USH-së. Janë zhvilluar intervista individuale me ekspertë të kërkimit, përfaqësues të partnerëve ndërkombëtarë, është realizuar një pyetësor me stafin akademik, ndihmës akademik e studentët, për çështje që konsiderohen të rëndësishme dhe që duhen trajtuar në Strategjinë e Kërkimit Shkencor të USH -së. Në vijim, janë organizuar takime të grupit të punës për analizën e situatës dhe një takim me ekspertë të përfshirë në fushën e kërkimit si dhe me ekspertë ndërkombëtarë, në të cilat është bërë analiza e situatës dhe janë dhënë ide për masat që duhen ndërmarrë për trajtimin e sfidave të identifikuar. Kjo fazë ka përfunduar me hartimin e një raporti të analizës së situatës;

Faza 3 –Përcaktimi i vizionit, qëllimit të politikave, objektivave specifike dhe treguesve përbën fazën e tretë të planifikimit. Kjo fazë është mbështetur në analizën e situatës duke dhënë përgjigje për objektivat e sfidat tashmë të identifikuar nga grupi i punës. Aktiviteti i parë ka qenë përcaktimi i vizionit dhe qëllimeve në fushën e kërkimit shkencor dhe më pas është kaluar në përcaktimin e objektivave strategjike, për të vazhduar më tej me përcaktimin e masave dhe



treguesve. Produkti i fazës së tretë ka qenë drafti i pjesshëm i Strategjisë së Kërkimit Shkencor i aprovuar nga Grupi i Koordinimit dhe i hartimit të Strategjisë së Zhvillimit të USH-së;

Faza 4–Kostimi i Strategjisë dhe plani i zbatimit. Gjatë kësaj faze është hartuar një plan i detajuar veprimi si dhe janë kostuar të gjitha masat për arritjen e objektivave dhe zbatimin e Strategjisë së Kërkimit Shkencor. Me këtë rast janë bërë disa ndryshime dhe plotësime të draftit të Strategjisë që ka rezultuar në draftin final të dokumentit;

Faza 5 – Konsultimi publik dhe finalizimi i dokumentit të Strategjisë.

Pas procesit të konsultimit me stafet, studentët, ekspertët kombëtarë e ndërkombëtarë do të finalizohet dokumenti i Strategjisë së Kërkimit Shkencor të USH-së.

3. Kuadri ligjor

3.1 Kuadri i politikave

Kuadri i politikave shtetërore për arsimin në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga strategji sektoriale e ndërsektoriale, si dhe dokumente të tjera të politikave që ndërlidhen me zhvillimin e arsimit, siç janë: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI II), Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, Agjenda digjitale e Shqipërisë 2015-2020, Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021-2023, Programi i Reformës Ekonomike 2021-2023, Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (SZHAPU), Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020. Pakti për Universitetin etj. Po ashtu, në kuadrin e politikave, bëjnë pjesë edhe dokumente ndërkombëtare në hartimin e të cilave ka marrë pjesë Republika e Shqipërisë, si Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në vijim do të prezantojmë një përshkrim të shkurtër të dokumenteve kryesore të politikave mbi të cilat mbështetet Strategjia Kombëtare e Arsimit 2022-2026.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI II) është dokumenti themelor strategjik që kombinon agjendën e integritimit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në fushën e arsimit të lartë Strategjia sjell 5 objektiva:

1. Rritjen në mënyrë të vazhdueshme të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor;
2. Mbështetjen dhe shtimin e programeve të studimit që kanë si synim përmbushjen e nevojave të tregut të punës;
3. Sigurimin e një arsimimi me karakter profesional që i përgjigjet nevojave të fushave specifike dhe zhvillimit të rajonit;
4. Rritjen e autonomisë dhe lirisë akademike të IAL-ve, duke krijuar mundësitë për kërkim shkencor si për stafin akademik ashtu edhe për studentët;

5. Ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë dhe rritjen e kontributit të “Albanian excellence” në tregun e punës.

Axhenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm. Në shtatorin e vitit 2015, Shqipëria dhe 192 shtete të tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara, miratuan Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Agjenda e vitit 2030 është një kornizë globale 15-vjeçare e përqendruar në 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ), njëra prej të cilave ndërlidhet me arsimin: **OZHQ4** (objektivi i zhvillimit të qëndrueshëm 4) Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë. Me synime të lidhura me fokusin e punës në institucionet e Arsimit të Lartë si më poshtë:

1. Qasje e barabartë në arsimin profesional dhe arsimin e lartë;
2. Zhvillim i aftësive për punësim;
3. Gjithëpërfshirje dhe eliminim i disparitetit gjinor;
4. Edukim për zhvillim të qëndrueshëm dhe qytetari globale.

Arsimi dhe Formimi 2020 (ET 2020) është kornizë strategjike për bashkëpunim midis vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit dhe të formimit. Duke u aprovuar ky dokument, vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë rënë dakord të punojnë drejt arritjes së këtyre synimeve në lidhje me arsimin e lartë:

- Të paktën 15% e të rriturve të marrin pjesë në të mësuarit gjatë gjithë jetës,
- Të paktën 40% e grupmoshës 30-34 të kenë kualifikim të lartë.

Kuadri për kompetencat kyç për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Në majin e vitit 2018, Bashkimi Evropian ka adoptuar Kuadrin e ri për kompetencat kyç për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020 është strategji ndërsektoriale që synon mbrojtjen dhe promovimin efektiv të të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë. Në kuadër të fushës strategjike 3 “*Sisteme dhe shërbime miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve/fusha e zhvillimit dhe arsimit*” prezantohen katër objektivat e mëposhtme, të cilat kanë si qëllim:

- Përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme (0 – 6 vjeç);
- Përmirësimin e cilësisë dhe aksesit në arsim për fëmijët në arsimin bazë;
- Përmirësimin e mekanizmave për mjedise gjithëpërfshirëse në arsimin parauniversitar;
- Përmirësimin e proceseve demokratike në shkolla.

Pavarësisht se lidhen me arsimin parauniversitar, këto synime janë shumë të vlefshme për orientimin didaktik dhe shkencor të përgatitjes së mësuesve në Fakultetet e Universitetit të Shkodrës.



Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020 ka për qëllim të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe të eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet publike dhe përfitimin e të drejtave të tyre. Ky plan sjell një qëllim strategjik për arsimimin e personave me aftësi të kufizuara që lidhet me arsimimin e kërkimin në institucionet e arsimit të lartë. Ky qëllim strategjik shprehet në këtë mënyrë: *Transformimi i shkollave të specializuara dhe universiteteve në qendra burimore për nxitjen e zhvillimit profesional të mësuesve dhe mësuesve ndihmës të shkollave të zakonshme, të cilët do të punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara.*

Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 ka për synim heqjen e pengesave me të cilat përballen romët dhe egjiptianët sa i përket aksesit në shërbime dhe përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës nëpërmjet integritimit dhe nxitjes së dialogut ndërkulturor. Një nga fushat e politikave të këtij plani ka të bëjë me promovimin e njohjes së identitetit Rom dhe atij Egjiptian si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë si dhe heqjen e kufizimeve për këtë komunitet në çdo fushë të arsimit.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020 është një dokument udhërrëfyes drejt një shoqërie të mundësive të barabarta e pa dhunë, në të cilën nevojat e grave dhe burrave merren në konsideratë dhe trajtohen në mënyrë të barabartë; gratë respektohen, mbrohen, nxiten e mbështeten për të ecur përpara njëloj si dhe burrat; vajzat e djemtë, rriten të lumtur e të gëzuar mes parimeve të barazisë e mosdiskriminimit - pra një shoqëri, që ka në bazë një familje të shëndoshë, komunitet mbështetës dhe institucione të konsoliduara që zbatojnë legjislacionin dhe detyrimet e tyre me përgjegjshmëri. Disa nga objektivat specifike që lidhen me fushën e arsimit të lartë, synojnë në:

- përmirësimin e kapaciteteve profesionale të mësuesve dhe psikologëve të shkollave për aplikimin në praktikë të kurrikulave të përmirësuara, të përgatitura për angazhimin e burrave dhe djemve kundër DHBGJ&DHF;
- shtimin e lëndëve specifike ndërgjegjësuese për çështjet e DHBGJ&DHF si dhe angazhimit të djemve dhe burrave kundër DHBGJ&DHF në programet e studimit në IAL në fushat e studimit: Shkencave Sociale (në degët ku mungojnë), Mësuesisë, Gazetarisë, Drejtësisë, Infermierisë etj.;
- përmirësimin e kapaciteteve të profesionistëve të shëndetësisë, arsimit dhe punonjësve të policisë për identifikimin e rasteve të mundshme të DHBGJ&DHF (në kuadër të parandalimit dhe informimit).

Agjenda digjitale e Shqipërisë 2015-2020 është strategjia ndërsektoriale e digjitalizimit të vendit. Në kuadër të prioritetit strategjik 3 “Politika për zhvillimin e infrastrukturës TIK dhe komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët”. Agjenda sjell një objektiv të ndërlidhur me sektorin e arsimit: “Digjitalizimi i sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar



në krijimin e një shoqërie bazuar në dije nëpërmjet rritjes së aksesit në kurrikula digjitale dhe mundësimin të lidhjes të tyre në internet (100%)". Disa nga veprimtaritë nëpërmjet të cilave synohet arritja e këtij objektivi në arsimin e lartë janë:

- pajisja e universiteteve me infrastrukturë funksionale për shfrytëzimin e informacionit (kompjuterë, laptopë, tableta smart);
- internet me shpejtësi të lartë dhe mundësi aksesimi online edhe në mjedise të tjera brenda universiteteve, jo vetëm në laboratorë;
- mbështetje teknike që siguron efikasitet të përdorimit të infrastrukturës;
- mundësi aksesimi në portale e platformat e kërkimit shkencor dhe projekteve;
- mundësi aksesimi në portale për studentët me aftësi të kufizuara;
- specifikim i kuadrit ligjor dhe infrastrukturor për shkëmbimin online të informacionit ndërmjet strukturave arsimore të arsimit të lartë.

Plani kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës digjitale 2020-2025 është strategji për instalimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës broadband në të gjitha sferat e jetës. Ndër shtatë objektivat specifike kombëtare për broadband-in për periudhën 2020-2025, janë dy që ndërlidhen drejtpërdrejt me arsimin:

- nga fundi i vitit 2025 100% e IAL-ve të jenë të lidhura me broadband me shpejtësi 1 Gbps;
- rrjeti Akademik Shqiptar të jetë pjesë e rrjetit evropian të High Performance Computer (HPC).

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2020-2022 ka për qëllim të koordinojë procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *Aquis* të BE-së, duke synuar njëkohësisht plotësimin e detyrimeve në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe detyrimet që lindin si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Arsimi përfshihet në kapitullin 26 të PKIE, ku përmbledhen hapat kryesorë që duhen ndërmarrë deri në vitin 2022.

Programi i Reformës Ekonomike 2021-2023 e trajton me përparësi cilësinë e arsimit dhe përfshirjen në arsim. Masa që lidhet me reformën në arsimin e lartë është fokusi në analizën dhe rishikimin e kurrikulës së re, si dhe në krijimin e kapaciteteve për zhvillimin profesional të mësuesve në kuadër të IAL-ve.

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021-2023 nuk parashikon ndonjë rritje të ndjeshme të buxhetit në nënsektorin e arsimit parauniversitar. Brenda periudhës 3 -vjeçare parashikohet rritje e buxhetit vjetor në arsimin e lartë me 21.9% në raport me vitin 2020.

Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020. Strategjia e aprovuar në janarin e vitit 2014 vazhdon ende të shërbejë si dokument bazë i politikave për zhvillimin e sektorit të arsimit parauniversitar. Katër shtyllat e saj janë:



- A. Përsosja e qeverisjes, udhëheqjes dhe menaxhimit të kapaciteteve dhe burimeve të strategjisë;
- B. Nxënia cilësore dhe gjithëpërfshirëse;
- C. Sigurimi i cilësisë bazuar në standarde të krahasueshme me ato të vendeve të BE-së;
- D. Përgatitja dhe zhvillimi profesional bashkëkohor i mësuesve dhe i drejtuesve.

Qëllimi i përgjithshëm i SZHAPU-së është të sigurojë gjithëpërfshirjen dhe qasjen e barabartë në arsimin për të gjithë. Në kontekstin e modernizimit të sistemit të saj arsimor, Shqipëria po krijon një program për gjithëpërfshirjen sociale dhe po bën përpjekje për përmirësimin e arritjeve të nxënësve në të gjitha nivelet si për shembull nëpërmjet zhvillimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca, zgjerimit të përdorimit të Teknologjisë dhe Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në arsim dhe rikonceptimit të formimit të mësuesve.


Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 ka për qëllim zhvillimin dhe koordinimin e politikave ndërsektoriale rinore në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe forcimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset vendimmarrëse. Një nga objektivat strategjike të këtij plani është “Edukimi i të rinjve”. Ky objektiv strategjik ndahet në gjashtë objektiva specifike, ndër të cilat të lidhura me arsimin e lartë janë:

1. Promovimi i Ekselencës dhe forcimi i kapaciteteve;
2. Mbështetja e kërkuesve të rinj shkencorë;
3. Përmirësimi i infrastrukturës së universiteteve dhe mjedisit të mësimdhënies;
4. Forcimi i shkollave të arsimit profesional;
5. Programet e edukimit për të rinjtë jashtë sistemit arsimor dhe atyre nga grupet minoritare/vulnerabile.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019 - 2022 synon të kemi një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që mbështetet tek “Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për gjithë femrat dhe meshkujt”. Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë është të nxisë vende pune cilësore dhe mundësi aftësimi për gjithë femrat dhe meshkujt shqiptarë gjatë gjithë ciklit të jetës. Ky qëllim do të arrihet me veprimtari politike koherente dhe të bashkërenduara, të cilat njëkohësisht i përgjigjen kërkesës dhe ofertës për punë si dhe sjellin mënjanimin e hendeqeve të përfshirjes sociale. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi përqendrohet në katër përparësi strategjike:

- a- Nxitjen e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës;
- b- Ofrimin e arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit;
- c- Nxitjen e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial;
- d- Fuqizimin e qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve profesionale.

Të gjitha këto përparësi lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me arsimin e lartë dhe forcimin e kapacitetit të tij shkencor.



Strategjia kombëtare e mbrojtjes sociale 2020-2023 ka si vizion të saj ndërtimin e një sistemi mbrojtjeje sociale që të luftojë pabarazitë socio-ekonomike, parashikimin e një sistemi që ka politikat dhe mekanizmat për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë ose të përjashtuar nëpërmjet programeve parandaluese dhe ri-integrimit social alternuar me skemat e punësimit”. Rritja e bashkëpunimit me strukturat arsimore të arsimit të lartë do të ketë si qëllim shkëmbimin reciprok të informacionit për fëmijët e moshës parashkollore dhe shkollore, për të realizuar vlerësimin e drejtë të aftësive për kryerjen e veprimtarive bazë të jetës, në përputhje me grupmoshat, si dhe për të siguruar identifikimin dhe plotësimin e nevojave aftësuese të këtyre fëmijëve në kuadrin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës e special, fokus i përgatitjes së mësuesve, psikologëve dhe punonjësve socialë në institucionet e arsimit të lartë.

Pakti për Universitetin u hartua në vitin 2018 dhe përbën një dokument angazhimesh për të trajtuar kërkesat studentore për kushte më të mira të studimeve, përmirësim të cilësisë, integritet akademik, transparencë dhe llogaridhënie në arsimin e lartë. Disa nga pikat kryesore të Paktit janë:

- Përmirësimi i mësimdhënies dhe infrastrukturës (IAL dhe konvikte);
- Transparenca me buxhetin në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë;
- Përfaqësimi i studentëve në Bordin e Administrimit të IAL-ve;
- Pajisja me Kartë Studenti e të gjithë studentëve;
- Verifikimi i plagjiaturave të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore;
- Ndërtimi i bibliotekave me standarde evropiane dhe me libër universitar online falas për studentët në gjuhën shqipe;
- Vlerësimi i performancës në mësimdhënie të personelit akademik nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve.

Vizioni, Misioni dhe treguesit e ndikimit të strategjisë

Kërkimi shkencor duhet të konsiderohet objektivi kryesor i punës për të gjitha strukturat e Universitetit, i njësuar me mësimdhënien.

USH do të jetë një qendër elitare rajonale që nëpërmjet kërkimit shkencor dhe ekspertizës profesionale të kontribuojë në zhvillimin e rajonit dhe më gjerë në përputhje me prioritetet e këtij zhvillimi në të gjitha fushat.

USH synon përparimin shkencor në koncept, teknologji dhe metodologji, zhvillimin e politikave krijuese dhe të programeve kërkimore në përputhje me programet shtetërore, kombëtare dhe rajonale përkatëse, duke synuar një vend të denjë në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA). USH duhet të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe konkurrues të punës kërkimore



shkencore krahas asaj mësimore përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave dhe strategjive sektoriale të saj në përputhje me ecurinë globale të evoluimit dhe zbatimit.

Vizioni përsa i përket kërkimit është:

- Të fokusojmë kërkimin shkencor në zgjidhje dhe shërbim të zhvillimeve sociale dhe ekonomike të komuniteteve dhe shoqërisë shqiptare.
- Të jemi shembull në praktikën tonë të bashkëpunimit dhe të jemi partner i zgjedhur dhe mbartës i praktikave më të mira në novacion dhe kërkim me ndikim në komunitet.

Ne dëshirojmë të rrisim shkallën, cilësinë dhe ndikimin e kërkimit tonë nëpërmjet nxitjes së të menduarit sipërmarrës në shkencë të stafit dhe studentëve tanë, si dhe nëpërmjet zhvillimit të partneriteteve të suksesshme me një sërë organizatash që drejtpërsëdrejti operojnë në kërkimin shkencor ose që e mbështesim atë me staf të kualifikuar, teknologji dhe informacion. Ne kërkojmë të jemi lider edhe në sigurimin, mbajtjen dhe forcimin e partneriteteve të qëndrueshme dhe frutdhënëse. Ne do të kërkojmë të bashkëpunojmë me institucione të ndryshme të sektorit publik e privat në mënyrë që të krijojmë dhe bëjmë shkencë me impakt pozitiv të dukshëm e të prekshëm në komunitet.

Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore të kërkimit shkencor, do të arrihet përmes:

- ✓ Trajnimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të stafit të Universitetit për të rritur dhe zgjeruar aftësitë kërkuese;
- ✓ Nxitjes së politikave të kërkimit shkencor në mënyrë që stafet dhe studentët të prodhojnë dije e kërkime të reja shkencore;
- ✓ Rritjes së pjesëmarrjes së stafëve akademike në programet kombëtare dhe ndërkombëtare (veçanërisht në ato në kuadër të BE-së) për kërkimin shkencor & inovacionin;
- ✓ Thellimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në kërkimin shkencor në fushat me interes të përbashkët;
- ✓ Stimulimit të ekselencës dhe rritjes së pjesëmarrjes së studentëve cilësorë në kërkimin shkencor, sidomos të atyre në nivelin e ciklit të dytë e të tretë të studimit.

Kërkimi

- Të fuqizojmë qendrat kërkimore dhe njësitë e kërkimit e bashkëpunimit për të mbështetur rritjen dhe t'i japin një vizibilitet të jashtëm më të madh programeve kërkimore;
- Të zhvillojmë kërkimin ndërdisiplinor nëpërmjet dy Qendrave tona kërkimore;
- Të shfrytëzojmë e të rrisim fondin e dedikuar për kërkimin shkencor;
- Të rrisim cilësinë e kërkimit të programet e masterave shkencorë dhe të nxisim kërkimin cilësor e me impakt në studimet doktorale;
- Të nxisim trajnimet për kërkim me institucione të huaja dhe partneritete me organizatat publike e private.



Novacion dhe impakt

- Të rrisim potencialin për novacion nëpërmjet nxitjes së novacionit në kurrikulat mësimore (Të ripërtërijmë, përshtasim dhe/ose rindërtojmë kurrikulat mësimore në përputhje me nevojën urgjente për novacion);
- Të punojmë me organizatat, universitetet dhe organet/autoritetet e qeverisjes lokale e kombëtare për të zhvilluar një sërë drejtimesh/orientimesh temash për kërkim shkencor dhe novacion që do të ndihmojnë në arritjen e nivelit të ekselencës në kërkim dhe realizimit të kërkimit me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet, gjë që do të ndihmojë në rolin dhe vlerën e novacionit, do të nxisë rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës në rajon e më gjerë.

6.3 Treguesit e impaktit të strategjisë

PJESA E DYTË QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

1. Objektivat

1.1 Objektivat afatshkurtër

- Nxitja e veprimtarisë kërkimore shkencore në fushat tradicionale dhe në ato që kanë një impakt të rëndësishëm në komunitet;
- Garantimi i sinergjisë midis kërkimit shkencor e mësimdhënies, sigurimi i pavarësisë së punës kërkimore;
- Nxitja e vazhdueshme e kualifikimit shkencor të stafit akademik;
- Krijimi i burimeve financiare të qëndrueshme të kërkimit shkencor përmes hartimit dhe pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe bashkëpunimit me pushtetin dhe biznesin lokal;
- Përditësimi me njohuritë dhe metodat e reja kërkimore me synim rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor;
- Shkëmbimi reciprok i njohurive të përftuara nga kërkimi shkencor dhe njohurive të fituara nga përvoja e Universiteteve Perëndimore;
- Stimulimi i studentëve elitë për të marrë pjesë në programet kërkimore shkencore;

1.2 Objektivat afatmesme

- Ushtrimi i funksionit të ligjshëm dhe përvojës së kërkimit shkencor universitar në hartimin e strategjive dhe politikave të zhvillimit social e ekonomik të qëndrueshëm të



rajonit në bashkëpunim me pushtetin dhe biznesin lokal e qendror duke pasur parasysh dhe faktorët analogë rajonalë meqenëse Shkodra është zonë kufitare;

- Vijimi dhe ristrukturimi i botimit të Revistës periodike “Buletini shkencor i USH-së” në pesë seritë e tij, i përmbledhjes “Studime shqiptare” si dhe botimi i rezultateve kërkimore edhe në revista shkencore të tjera kombëtare e ndërkombëtare etj.;

1.3 Objektivat afatgjatë

- Ndërkombëtarizimi i kërkimit shkencor, duke krijuar sinergji dhe partneritet me universitetet e institutet e tjera kërkimore brenda vendit apo me grupet kërkimore të huaja me qëllim integrimin në hapësirën e kërkimit shkencor evropian;
- Sigurimi i një pozicioni lider dhe të njohemi në plan kombëtar e më gjerë për cilësinë dhe rëndësinë e kërkimit;
- Krijimi i një mjedisi kërkimi të qëndrueshëm dhe i një kulture të gjallë e bashkëpunuese kërkimi, duke mbështetur bashkëpunimin ndërdisiplinor brenda dhe jashtë universitetit.
- Sigurimi i burimeve për zhvillim kapacitetesh e rritje në fushat e kërkimit bazuar në sfidat kombëtare e ndërkombëtare;
- Të qenit shembull në praktikat tona të bashkëpunimit për krijimin e partneriteteve për novacion dhe krijimin e impaktit në komunitet;
- Bashkëpunimi me organizata e universitete në nivel kombëtar e ndërkombëtar për të siguruar vizibilitet dhe akses në mundësitë e bashkëpunimeve në kërkim dhe për të siguruar rezultate kërkimi me cilësi dhe ndikim;
- Rritja e angazhimit mbarëuniversitar duke nxitur një kulturë përfshirjeje në çdo pjesë të universitetit, duke krijuar partneritete të forta e të qëndrueshme me komunitetin, shoqërinë civile dhe sektorë bazë të zhvillimit ekonomik-social lokal e zonal, si: industria, agrokultura, blegtoria, turizmi;
- Të qenit lider në novacion e sipërmarrje në Veriun e Shqipërisë dhe më gjerë.

Këto qëllime dhe objektiva vijnë në vazhden e prioriteteve për kërkim, inovacion dhe partneritet të USH-së.

2. Objektivat specifike

2.1 Objektivi specifik 1

Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor arrihet përmes:

- Krijimit të një infrastrukture të përshtatshme të kërkimit shkencor;
- Identifikimit të individëve apo grupeve kërkuese, të cilët kanë arritje në kërkimin shkencor;

- Krijimit të grupeve kërkimore të reja, duke i riorganizuar departamentet dhe qendrat kërkimore sipas drejtimeve bazë prioritare të fushave studimore;
- Hapjes së shkollave të doktoraturës në fakultete ose në mes departamenteve ku ekzistojnë kapacitetet akademike dhe infrastruktura përkatëse;
- Rritjes së pjesëmarrjes në projekte shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare që të krijojnë dhe zgjerojnë hapësirat e komunikimit dhe shkëmbimit të përvojës në kërkim shkencor e veçanërisht në teknologji dhe infrastrukturë;
- Mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me universitetet dhe institucionet shkencore dhe arsimore të Tiranës, të universiteteve të tjera shqiptare, universiteteve të rajonit dhe më gjerë si dhe shtimit të mobilitetit të dyanshëm të kërkuesve shkencorë dhe studentëve.

2.2 Objektivi specifik 2. Përsosmëria në kërkim e lidhja me mësimdhënien si dhe lidhja me tregun e punës.

Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore të kërkimit shkencor do të arrihet përmes:

- Trajnimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të stafit të Universitetit për të rritur dhe zgjeruar aftësitë kërkuese që lidhen me mësimdhënien e tregun e punës, kërkesat e zhvillimit rajonal e më gjerë;
- Nxitjes së politikave të kërkimit shkencor në mënyrë që stafet dhe studentët të prodhojnë dije e kërkime të reja shkencore në shërbim të shoqërisë, zhvillimit të saj ekonomik dhe social si dhe ruajtjes së vlerave të trashëgimisë, kulturore, gjuhësore, natyrore, historike etj.;
- Rritjes së pjesëmarrjes së stafeve akademike në programet kombëtare dhe ndërkombëtare (veçanërisht në ato në kuadër të BE-së) për kërkimin shkencor dhe inovacionin;
- Thellimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në kërkimin shkencor në fushat me interes të përbashkët rajonal;
- Fuqizimit të qendrave kërkimore dhe njësisive të kërkimit e bashkëpunimit për të mbështetur rritjen dhe për t'i dhënë një vizibilitet të jashtëm më të madh programeve kërkimore;
- Zhvillimit të kërkimit ndërdisiplinor nëpërmjet dy Qendrave tona kërkimore për t'i bërë ato të afta për të hartuar projekte zhvilluese që japin e gjenerojnë të dhëna për tregun;
- Shfrytëzimit dhe rritjes së fondit për kërkimin shkencor;
- Rritjes së cilësisë së kërkimit tek programet e masterave shkencorë dhe nxitjes së kërkimit shkencor cilësor e me ndikim në studimet doktorale;
- Rritjes së pjesëmarrjes në trajnime për kërkim me institucione të huaja dhe partneritete me organizatat publike e private.



2.3 Objektivi specifik 3. Plani i barazisë gjinore në kërkimin shkencor.

2.4 Objektivi specifik 4. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor.

Krijimi i mundësive për të gjithë studentët që nga viti i dytë i studimeve Bachelor dhe më pas nga programet Master e Doktoraturë të përfshihen në projekte që udhëhiqen prej tyre, por edhe në bashkëpunim me stafet akademike.

2.5 Objektivi specifik 5. Integriteti dhe transparencë.

2.6 Objektivi specifik 6. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Universiteti i Shkodrës, gjatë periudhës 2022 — 2026 duhet të sigurojë standardet e nevojshme për realizimin e një pune kërkimore e shkencore sa më cilësore duke synuar pjesëmarrje në mënyrë aktive dhe të suksesshme në Programet Kuadër të BE-së, për Kërkim Shkencor e Inovacion në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA), si dhe në format e ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkencës.


Universiteti duhet të nxisë qendrat e ekselencës së kërkimit shkencor në bazë të parimit të një specializimi të zgjuar dhe të mbështesë politikat e shkencës së hapur (open science) dhe marrjes së informacionit (open access) mbi rezultatet e botimeve shkencore që financohen nga fondet publike.

Të luftohet për një kërkim shkencor të aftë që të konkurrojë në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Universiteti duhet të kryejë veprimtari studimore-shkencore në fushat tradicionale, në ato që kanë lidhje me komunitetin si edhe të stimulojë fusha të reja. Ai duhet ndihmojë në përmirësimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukture të kërkimit shkencor si dhe të përpiqet për fitimin e të ardhurave përmes një pune cilësore kërkimore, projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe bashkëpunimit me pushtetin dhe biznesin lokal e rajonal.

2.7 Objektivi specifik 7. Shërbimet digjitale në funksion të kërkimit shkencor.

- Krijimi i platformave online;
- Forcimi i kapaciteteve të stafeve për të përdorur platformat online për kërkimet e tyre shkencore, publikimet si dhe të dhënat;
- Krijimi i lidhjeve me universitetet e tjera për të krijuar platforma të përbashkëta në shërbim të kërkimit shkencor dhe inovacionit.



PJESA E TRETË. ZBATIMI I STRATEGJISË DHE PËRGJEGJËSIA, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

3.1 Mbi bazën e Vendimit nr. 97 nr.1026 prot, datë 29.03.2021 të SA u përcaktuan prioritetet e kërkimit shkencor në USH në këto fusha:

- Albanologjia,
- Biodiversiteti dhe ndotja e mjedisit,
- Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm,
- Integrimi Evropian,
- Reforma në drejtësi,
- Shkencat sociale dhe pedagogjike,
- Studimet territoriale,

3.2 Zbatimi i strategjisë së kërkimit shkencor

- Thelbi i strategjisë së kërkimit -shkencor të USH-së do të jetë të ndikojmë pozitivisht në komunitetet lokale dhe njerëzit brenda rajonit tonë dhe më gjerë. Ne duam të trajtojmë sfidat kulturore, sociale, mjedisore dhe ekonomike përmes kërkimit, inovacionit dhe shkëmbimit të njohurive të angazhuara nga publiku dhe komuniteti.
- Ngritja e kapaciteteve akademike-kërkimore veçanërisht e instituteve të studimit në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 2015, dhe fuqizimi i tyre për të sjellë projekte kombëtare dhe ndërkombëtare kërkimore në fushat prioritare të kërkimit shkencor të USH-së;
- Sigurimi i autonomisë financiare në nivel Fakulteti për të motivuar stafet që të orientojnë kërkimin shkencor në drejtimet që zhvillimet socialekonomike kërkojnë dhe të sigurimit të ardhurave nga puna kërkimore.
- Përmirësimet në infrastrukturën kërkimore (mjete, pajisje, laboratore shkencore etj.).
- Mbështetja me fonde nga USH dhe AKKSHI për pjesëmarrje në konferenca e simpoziume shkencore, për botime të studimeve të rëndësishme dhe të artikujve shkencorë në revista cilësore dhe me faktor impakti etj.;
- Pasurimi i Bibliotekës së Universitetit me tituj të rinj botimesh që u vijnë në ndihmë pedagogëve për kërkimin shkencor;
- Abonimi i Universitetit të Shkodrës në disa Librari digjitale prestigjioze;
- Organizimi i përvitshëm nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” (në secilën prej fushave të kërkimit shkencor të listuara më sipër në pikën 3.1) i aktiviteteve shkencore (simpoziume, konferenca) kombëtare dhe aplikimi po i përvitshëm për të qenë lider në organizimin e aktiviteteve shkencore të larpërmendura, në nivel ndërkombëtar me qëllim promovimin e realizimit të planit strategjik të novacionit.

INICIATIVA KONKRETE

- AKREDITIMI I LABORATORIT MIKROBIOLOGJIK;
- SIGURIMI I NJË PARTNERITETI MË NJË UNIVERSITET PERËNDIMOR NGA PRESIDENCA E REKTORES NË KONFERENCËN AARC;
- Hapja e programit të doktoraturës në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” ku projektet kërkimore-shkencore me përfshirjen e stafëve (udhëheqës) dhe studentëve (doktorantëve) do të mbulohen çdo vit nga buxheti i USH-së, fonde të projekteve me financim EU dhe mbështetjen financiare të bizneseve;
- Investimi në Laboratorin e Ushqimit dhe Pijeve në shërbim të studentëve të FE-së dhe si mjet për të rritur të ardhurat nga puna kërkimore dhe praktike në lidhje me bizneset e fushës së turizmit;
- Krijimi i Inkubatorit të Biznesit (projekti U-SIA) i cili do të ketë synim lidhjen e stafit akademik dhe studentëve të FE-së me bizneset nëpërmjet studimeve dhe punës kërkimore në shërbim të komunitetit të biznesit.
- Krijimi i Qendrës së Zhvillimit të Qëndrueshëm e cila është realizuar nga projekti FOST INNO, por në të ardhmen do të japë mbështetjen e duhur.
- Mbështetje financiare e Qendrës së Ekselencës në adresimin e çështjeve të arsimit të lartë siç janë cilësia e mësimdhënies, inovacionet në metodat e mësimdhënies në lidhje me teknologjitë e reja – Laboratori Virtual projekti VALEUX;
- Krijimi i një qendre trajnimi për bizneset me synim ngritjen e kapaciteteve të tyre menaxheriale.

3.1 Monitorimi dhe raportimi

Përgjegjës për monitorimin e objektivave të Strategjisë së Kërkimit do të jenë strukturat përgjegjëse për kërkimin shkencor, të cilët i raportojnë Senatit të USH-së dhe Asamblesë së USH-së realizimin e objektivave.

3.2 Vlerësimi

Vlerësimi i Strategjisë së Kërkimit bëhet sipas objektivave të saj çdo vit duke u prezantuar në SA pengesat në realizimin e tyre si dhe arritjet dhe shembujt më të mirë të punës kërkimore-shkencore mbi bazë Fakulteti, Departamenti, pedagogësh individualisht si pjesë e Raportit të Analizës Shkencore vjetore.

3.3 Plani i veprimit dhe burimet financiare të veprimitarisë kërkimore-shkencore:

3.3.2 Plani i veprimit të veprimitarisë kërkimore-shkencore do të fokusohet në këto drejtime:

- Të fuqizojmë departamentet dhe grupet kërkimore- shkencore ndërdisiplinore që mund të krijohen mes departamenteve dhe Fakulteteve të USH-së për të aplikuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe menexhimi i projekteve fituese të kryhet në mënyrë profesionale dhe në pavarësi të plotë;

- Të mbështesë zhvillimin e vendit e sidomos Veriun e Shqipërisë në sfidat e vazhdueshme që ato kanë;
- Të krijojmë një mjedis kërkimi të qëndrueshëm dhe një kulturë të gjallë e bashkëpunuese kërkimi, duke mbështetur bashkëpunimin ndërdisiplinor brenda dhe jashtë universitetit;
- Të zhvillojmë një kërkim ndërdisiplinor nëpërmjet zgjerimit të qendrave kërkimore;
- Të krijojmë komunitete të reja përtej disiplinave, të identifikojmë nevojat infrastrukturore dhe të stimulojmë fusha të reja në aktivitetet e kërkimit që mund të na hapin mundësi të reja financimi për kërkim;
- Të mbështesim kërkimin duke i dhënë më tepër vizibilitet të jashtëm kërkimit ekzistues;
- Të vazhdojmë të investojmë në mjedisin e kërkimit fizik dhe digjital nëpërmjet një infrastrukture akademike të cilësisë së lartë dhe një infrastrukture digjitale mbështetëse, fleksibël e të sigurt;
- Të sigurojmë standarde të larta të kërkimit në cilësi dhe integritet dhe të jemi të angazhuar në nxitjen e një kulture pozitive të integritetit të kërkimit për komunitetin tonë të kërkimit. Kërkimi dhe inovacioni me përgjegjshmëri ndërtohet mbi bazat e një sistemi të sigurimit të cilësisë që na lejon të arrijmë kërkim të rëndësishëm dhe novator. Ky sistem përfshin politika, procedura e procese të qarta për të mbështetur kërkuesit për realizimin e projekteve kërkimore të cilësisë së lartë dhe për të siguruar që ata të jenë të ndërgjegjshëm për standardet e pritshme gjatë realizimit dhe shpërndarjes së punës së tyre kërkimore, mundësi për zhvillim dhe orientim për të inkurajuar ecuri pozitive të kërkuesve në të gjitha fazat e karrierës së tyre, sistem menaxhimi e monitorimi për t'u siguruar që po zbatohen etika dhe integriteti në kërkim;
- Të monitorojmë vazhdimisht treguesit e performancës për kërkim dhe novacion në rang institucional. Për këtë do të adoptojmë një praktikë të përgjegjshme për përdorimin e metrikëve për vlerësimin e menaxhimit e kërkimit;
- Të sigurojmë burime për zhvillim kapacitetesh e rritje në fushat e kërkimit, bazuar në sfidat kombëtare e ndërkombëtare;
- Të nxisim gatishmërinë dhe fleksibilitetin institucional ndaj mjedisit të jashtëm dhe nevojave të kërkuesve tanë;
- Të vlerësojmë mundësitë strategjike dhe të zhvillojmë marrëdhënie me sektorin privat e publik për të rritur vizibilitetin dhe për t'u siguruar që jemi të aftë për të reaguar dhe për të ndikuar në prioritetet strategjike;
- Të përdorim maksimalisht fondin për kërkimin shkencor në mbështetje të aktiviteteve kërkimore të reja e transformuese, për të mbështetur e fuqizuar kërkuesit në prioritetet kombëtare e ndërkombëtare të kërkimit;
- Të jemi shembull në praktikat tona të bashkëpunimit për krijimin e partneriteteve për novacion dhe krijimin e impaktit në komunitet;
- Të bashkëpunojmë me organizata e universitete kombëtare e ndërkombëtare për të siguruar vizibilitet dhe akses në mundësitë e bashkëpunimeve në kërkim dhe për të siguruar rezultate kërkimi me cilësi dhe impakt;



- Të sigurojmë dhe zhvillojmë në mënyrë aktive një partneritet strategjik institucional me organizata e universitete kombëtare e ndërkombëtare nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale apo multilaterale që adresojnë prioritetet në edukim e kërkim shkencor;
- Të bashkëpunojmë me institucionet në plan lokal e kombëtar për të adresuar sfidat për zhvillim ekonomik e mirëqenie si dhe të zhvillojmë më tej partneritetet tona për të mbështetur novacionin në komunitet;
- Të zhvillojmë partneritetet në rang ndërkombëtar për të mbështetur bashkëpunimin ndërkombëtar në kërkim dhe mobilitetin e kërkuesve;
- Të jemi një universitet i angazhuar, duke nxitur një kulturë përfshirjeje në çdo pjesë të universitetit, duke krijuar partneritete të forta e të qëndrueshme me komunitetin dhe industrinë;
- Të sigurojmë një angazhim maksimal e cilësor ndërmjet universitetit e partnerëve, grupeve të interesit e publikut. Ne e njohim vlerën që angazhime të tilla sjellin në kërkimin e rezultateve tona dhe përfitimin përkatës për të gjithë partnerët e përfshirë. Do të zhvillojmë struktura, procese e praktika në USH që të sigurojnë një mjedis mbështetës për kërkuesit;
- Të bashkëpunojmë me sektorin privat e publik dhe për të nxitur kërkimin me impakt në komunitet;
- Të fokusojmë kërkimin shkencor, inovacionin dhe studime territoriale në drejtim të sfidave kryesore të zhvillimeve social-ekonomike e sipërmarrjeve në Rajonin Verior të Shqipërisë dhe më gjerë;
- Të bashkëpunojmë e të zhvillojmë më tej partneritetet tona për të mbështetur novacionin në komunitet duke bashkëpunuar me sektorin privat e publik në vend për të përcaktuar një sërë temash për kërkim e novacion të cilat mund të çohen më tej nëpërmjet bashkëpunimit për të orientuar drejt novacionit, rritjes ekonomike dhe krijimit të vendeve të punës në zonën e Veriut të Shqipërisë e më tej.

3.3.2. Burimet financiare të Kërkimit Shkencor

Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare dhe ndërkombëtare. Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor në përputhje me planin strategjik të USH-së, të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë.

Të gjitha të ardhurat e krijuara nga njësia kryesore/njësia bazë përdoren prej tyre dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës.

Burimet e financimit janë:

- Buxheti i USH-së;
- Granti i punës kërkimore- shkencore ku përfshihen edhe fondet për studimet e doktoratës që iu jepen Universiteteve nga AKKSHI mbi bazën e aplikimit. Nga ky fond përjashtohet financimi i ngarkesës së pedagogëve për udhëheqjen e doktoratës;

- Fondet nga projektet ndërkombëtare;
- Të ardhurat që krijohen nga pagesat e studentëve për studimet, shërbimet e kryera nga njësia kryesore/ njësia bazë ku bëjnë pjesë grupi i kërkuesve;
- Të ardhurat nga trajnimet e realizuara për bizneset.

Plani i veprimit të strategjisë sektoriale të kërkimit dhe inovacionit është mbështetur mbi strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Shkodrës për periudhën 2022-2026.

Përmes zhvillimit të programeve kërkimore, Universiteti i Shkodrës, përpiket të jetë një nga qendrat kërkimore më të njohura në Shqipëri, në rajon dhe më gjerë.

Aneks 1. Analiza SWOT e KËRKIMIT SHKENCOR NË USH

Pikat e forta:

- ✓ Një traditë e rëndësishme në punën kërkimore shkencore;
- ✓ Një sërë arritjesh në punën kërkimore shkencore nga individë ose grupe studiuesish;
- ✓ Rritje e pjesëmarrjeve të stafit të brendshëm në projekte kërkimore ndërkombëtare apo mësimdhënie jashtë vendit
- ✓ Pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
- ✓ Një staf akademik relativisht të kualifikuar dhe me vullnet për të punuar;
- ✓ Prania e ciklit të dytë dhe të tretë të shkollimit (master shkencor dhe doktoraturë);
- ✓ Një numër i konsiderueshëm i bashkëpunimeve të ngushta me institute dhe grupe kërkimore brenda dhe jashtë vendit.

Pikat e dobëta

- ✓ Mungesa në stafin kërkimor të brendshëm ose ekspertëve në disa fusha kryesore, si: histori, arkeologji, limnologji (hidrologji), iktiologji etj.; numër i vogël i studentëve cilësorë në ciklin e dytë të studimit (“Master shkencor”);
- ✓ Ndërhyrja e drejtuesve të USH-së në mënyrë arbitrare në menaxhimin e projekteve ndërkombëtare të cilat fitohen nga puna e stafeve akademike, demotivon stafet akademike për të sjellë më shumë fonde në shërbim të kërkimit shkencor.
- ✓ Financim i dobët për kërkimin shkencor;
- ✓ Mungesa e autonomisë financiare në nivel Fakulteti dhe Departamenti
- ✓ Disa mungesa në infrastrukturën kërkimore; numër i kufizuar i laboratorëve në dispozicion të kërkimit shkencor dhe mangësi serioze të pajisjes së tyre me aparatura, teknologji e bazë materiale bashkëkohore në funksion të kërkimit shkencor;
- ✓ Mungesë të financimeve permanente për kërkimin shkencor;



- ✓ Mungesa e vogël e mundësi të pakta për gjenerimin e të ardhurave për vetëmenaxhim të kërkimit shkencor;
- ✓ Mungesë përvoja në hartimin e projekteve ndërkombëtare;
- ✓ Hapësirë e kufizuar e stafit akademik të kualifikuar.

Mundësitë

- ✓ Pjesëmarrje më e gjerë në projektet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- ✓ Hapja e programeve profileve të reja të masterave shkencorë dhe shkollës së doktoraturës;
- ✓ Rritje me përfitim reciprok e bashkëpunimit me pushtetin lokal e rajonal dhe me sektorin e biznesit;
- ✓ Rritje e bashkëpunimit me IAL-të e tjera publike dhe jopublike brenda vendit si dhe me Universitete të ndryshme në Evropë e më gjerë.

Kërcënimet

- ✓ Konkurrenca nga Universitetet e tjera shqiptare, shtetërore dhe private si dhe Universitetet e Rajonit të Ballkanit që janë më aktiv në tërheqjen e fondeve evropiane.
- ✓ Mungesa e kërkimit shkencor cilësor për shkak të mbështetjes së pakët financiare për kërkimin shkencor;
- ✓ Krijimin e vonesave në fitimin e gradave dhe titujve shkencorë nga stafi akademik si pasojë e mungesës së infrastrukturës së përshtatshme, financimit etj. të kërkimit shkencor.

Grupi i Punës:

Arjeta Troshani

Aurora Dibra

Brilanda Bushati

Enriko Daka

Eugena Bisha

Florian Mandisa





STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT TE UNISHK 2022-2026

**STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT E
UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”
2022-2026**



Tabela e Përmbajtes

<i>Lista e shkurtimeve</i>	3
<i>Hyrje</i>	4
<i>Filozofia jonë e ndërkombëtarizimit</i>	5
<i>Parimet e përgjithshme</i>	6
• Kultura e bashkëpunimit dhe reciprociteti	6
• Angazhimi	6
• Përgjegjshmëria sociale	6
• Cilësia	6
• Fokusi rajonal	6
• Fokusi tek studenti	6
• Parimi i transparencës	7
• Parimi i lidhjeve afatgjata	7
<i>Qëllimi</i>	8
• Objektivat	8
<i>Fushat e ndërkombëtarizimit</i>	8
• Skemat e bursave	8
• Partneritetet	9
• Partneritetet e mësimdhënies	9
• Partneritetet kërkimore	9
• Partneritetet për mobilitetin e studentëve	10
• Kurrikula ndërkombëtare	100
• Kërkimi	11
• Mobiliteti i stafit akademik	112
Raportimi	12
Mbështetja financiare	12
<i>Plani i veprimit 2022-2026</i>	133
<i>Aneksi Nr 1. Lista e projekteve ndërkombëtare të zhvilluara në USH</i>	Error! Bookmark not defined.5
<i>Aneksi Nr 2. Lista e Universiteteve në kuadër të marrëveshjeve të Credit Mobility (KA1)</i> ...	Error! Bookmark not defined.6



Lista e shkurtimeve

CISVA- Centro Interuniversitario degli Studi del Viaggio Adriatico

DZHMJ- Dega e Zhvillimit të Marrëdhënieve me Jashtë

IAL- Institucione të Arsimit të Lartë

FE- Fakulteti Ekonomik

FD- Fakulteti i Drejtësisë

FSHE - Fakulteti i Shkencave të Edukimit

FSHN - Fakulteti i Shkencave të Natyrës

FGJH- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

FSHSH - Fakulteti i Shkencave Shoqërore

IT–Information TechnologyECTS-

European Credit Transfer System

MAS - Ministria e Arsimit dhe Sportit

USH - Universiteti i Shkodrës



Hyrje

Strategjia e ndërkombëtarizimit të Universitetit të Shkodrës është pjesë përbërëse e strategjisë kryesore të këtij Universiteti. USH synon të rrisë reputacionin e tij ndërkombëtar përmes cilësisë së arsimit që siguron, ndikimit të kërkimeve që realizon dhe shërbimeve që ofron për shoqërinë.

Ndërkombëtarizimi përfshin të gjitha aspektet e jetës universitare: kërkimin, mësimdhënien dhe administrimin. Nëpërmjet kësaj strategjie synohet një shkallë më e lartë njohje e këtij Universiteti në rajon dhe më gjerë duke promovuar aktivitetet e tij. Aktivitetet ndërkombëtare të Universitetit të Shkodrës janë stimuj të kërkimit shkencor, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe përditësimit të metodave të mësimdhënies. Këto aktivitete janë gjithashtu një aspekt kyç i veprimitarisë së Universitetit. Përmes projekteve kërkimore ndërkombëtare, mobiliteteve të studentëve, administratës e shërbimeve si dhe stafit akademik, mund të kontribuohet në rritjen e cilësisë së administrimit, mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në të gjitha fushat që mbulon Universiteti.

Të jesh një Universitet ndërkombëtar do të thotë: të zhvillosh komunitete multikulturore të studentëve dhe stafit; të sigurosh mjedis mbështetës për përvojën arsimore që përgatit studentë për mjediset politike dhe sociale globale; të zhvillosh aleanca dhe partneritete ndërkombëtare për të mbështetur dhe ngritur kapacitetet dhe aftësitë në kërkim, edukim dhe sipërmarrje. Ndërkombëtarizimi i USH-së ndihmon në rritjen e autoritetit dhe vizibilitetit të USH-së në mjediset universitare e më gjerë, duke u përfshirë në një numër më të madh bashkëpunimesh dhe partneritetesh më të ngushta dhe më cilësore me universitete të huaja dhe institute kërkimore ndërkombëtare. Përmes strategjisë së ndërkombëtarizimit stafi dhe studentët do të kenë mundësi udhëtimi që do t'i ndihmojnë ata të kenë sukses në pozicionet e tyre në tregun e punësimit global.

Kjo strategji përbën një dokument në të cilin përshkruhen me përparësi strategjia për vitet e ardhshme, të cilat pasqyrojnë *Misionin dhe Vizionin e Universitetit të Shkodrës për vitet 2021-2026*.

Në vazhdimësi me Planin e mëparshëm, linjat strategjike të ilustruara në këtë dokument vazhdojnë të përshkruajnë një projekt ambicioz për Universitetin tonë, në shërbim të sistemit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar, të territorit dhe të vendit; një projekt që kërkon pjesëmarrjen e plotë, angazhimin dhe kontributin e të gjithë stafit administrativ dhe stafit akademik të Universitetit tonë për t'u zbatuar.



Fitozofia jonë e ndërkombëtarizimit

Politika e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Shkodrës dhe Universiteteve të tjera të huaja konkretizohet me nënshkrimin e marrëveshjeve respektive të cilat nxisin aktivitetet e mëposhtme:

- Shkëmbime edhe bashkëpunime reciproke të profesorëve, kërkuesve, studentëve dhe stafit administrativ në nivel universitar dhe pasuniversitar (Erasmus dhe Tempus);
- Organizimin e shkollave verore, seminareve dhe formave të tjera të shkëmbimit të njohurive;
- Shkëmbimin e literaturave, teksteve dhe publikimeve universitare;
- Realizimin e projekteve të përbashkëta (Horizon 2020);
- Shkëmbim eksperiencash në programe reciproke në fushën e sistemeve të informacionit dhe komunikimit;
- Shkëmbim i stafit administrativ me qëllim përfitim eksperience në mirëmenaxhimin e Universitetit;
- Bashkëpunimin në fushën e reformës universitare sipas Deklaratës së Bolonjës dhe Deklaratës së Lisbonës;
- Krijimin e grupeve të përbashkëta kërkimore për fusha që mbulon Universiteti;
- Krijimin e masterave të përbashkët;
- Konferenca shkencore ndërkombëtare;
- Forma të tjera bashkëpunimi me qëllim që të jenë reciprokisht përfituese të dyja palët.



Parimet e përgjithshme

- **Kultura e bashkëpunimit dhe reciprociteti**

Ndërkombëtarizimi është një proces i dyanshëm. Puna shumëpalëshe do të na japë mundësi të arrijmë objektivat në termat e mësimdhënies në mënyrë që të promovojë kulturën, njohuritë shkencore si dhe përfitimin e aftësive të reja, kërkimit shkencor në mënyrë që të ketë progres të njohurive dhe inovacionit në fusha të reja si dhe transferimit të dijeve jashtë ambientit të universitetit tonë.

USH i kushton rëndësi krijimit dhe zhvillimit të një kulture bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përfitimit të ndërsjelltë. Kjo realizohet nëpërmjet krijimit të kushteve më të mira dhe krijimit të mekanizmave e procedurave që nxisin dhe mbështesin aktivitetet e ndërkombëtarizimit. Ne do të fokusohemi në kultivimin e marrëdhënieve të shumëfishta duke eliminuar barrierat dhe duke u nisur nga përfitimi reciprok i palëve të përfshira.

- **Angazhimi**

Ndërkombëtarizimi është një investim për të ardhmen dhe kërkon angazhim afatgjatë si nga ana e stafit administrativ dhe akademik të USH-së ashtu edhe nga ana e studentëve dhe e partnerëve.

- **Përgjegjshmëria sociale**

Arsimi i lartë është një e mirë publike dhe sociale. Si e tillë, USH ndjen përgjegjësinë për të gjeneruar dhe ndarë dijet, njohuritë për më të mirën e shoqërisë. Gjithashtu USH është e ndjeshme edhe ndaj ngjarjeve dhe zhvillimeve rajonale. Ne jemi të angazhuar të zhvillojmë kapacitetet jo vetëm në vendin tonë, i cili konsiderohet si një vend në zhvillim, por edhe në rajon (BALLKAN) duke ndikuar kështu në një qëndrueshmëri më të lartë. Njëkohësisht ne jemi të anagazhuar të zhvillojmë bashkëpunime edhe me Universitete apo institute kërkimore në vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

- **Cilësia**

Ne kemi si qëllim të mbajmë standarde të larta në të gjitha aktivitetet që ndërmarrim, si në fushën e mësimdhënies, të kërkimit shkencor ashtu edhe në bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për zhvillimin e projekteve të ndryshme.

- **Fokusi rajonal**

USH ka si qëllim të përqendrojë përpjekjet dhe burimet e saj edhe në bashkëpunimet me vendet e rajonit, përveç bashkëpunimit me vendet evropiane dhe në nivel kombëtar.

- **Fokusi tek studentit**

Studentët janë një forcë shumë e madhe shtytëse e ndërkombëtarizimit. Ne synojmë që



STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT TE UNISHK 2022-2026

nismat dhe programet ndërkombëtare të marrin në konsideratë në mënyrë sistematike nevojat, pritshmëritë dhe eksperiencat e studentëve. Ne besojmë se studentët duhen fuqizuar që të aktivizohen dhe menaxhojnë vetë aktivitete ndërkombëtare. Projektet dhe organizata studentore do të jenë krahu ynë i djathtë dhe do të mbështeten, asistohen dhe trajnohen për t'i angazhuar në aktivitete ndërkombëtare.

- **Parimi i transparencës**

USH i kushton rëndësi vënies në dispozicion të të gjithë informacionit të vlefshëm për stafin dhe studentët për t'u njohur me mundësitë e bashkëpunimit dhe mobilitetet e dyanshme, si dhe zbatim transparent të procedurave përkatëse.

- **Parimi i lidhjeve afatgjata**

USH i kushton rëndësi krijimit dhe ruajtjes së lidhjeve afatgjata me ish-studentë (alumni) dhe ish-anëtarë të stafit akademik që punojnë në universitete të huaja, institute kërkimore ose organizata të tjera. Përfshirja e kapaciteteve intelektuale të diasporës shqiptare dhe alumni kontribuon në shtimin e potencialeve në USH në fusha të ndryshme duke rritur kështu nivelin e shkëmbimit dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar.



Qëllimi

Universiteti i Shkodrës nxit veprimtaritë ndërkombëtare dhe inkurajon zbatimin e tyre në të gjitha aktivitetet e përditshme të Universitetit. Zhvillimi strategjik i Universitetit është i bazuar në orientimin e tij ndërkombëtar dhe vë theksin e tij në rëndësinë e të qenit pjesë e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. Mobiliteti i stafit akademik, administratës, shërbimeve dhe studentëve, si një pjesë e bashkëpunimit ndërkombëtar, është një qëllim strategjik shumë i rëndësishëm në zhvillimin e Universitetit të Shkodrës.

Në kuadër të ndërkombëtarizimit qëllimi i USH-së është:

1) Të nxisë dhe përmirësojë cilësinë e jetës jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të vendeve të tjera dhe kjo përmes qasjes sonë të ndërkombëtarizimit në nivelin e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies. Konkretisht kjo synohet të realizohet përmes zbulimeve, shpërndarjes së dijeve dhe inovacionit.

2) Të sigurojë mësimdhënie, kërkim shkencor dhe transferim të dijeve drejt grupeve të interesit të jashtëm, në nivel sa më të lartë dhe të ngjashëm me standardet ndërkombëtare.

Strategjia e ndërkombëtarizimit të USH-së buron nga strategjia e përgjithshme e USH-së dhe vjen në përputhje të plotë me këtë të fundit.

• Objektivat

- Të zgjerojë, inkurajojë dhe mbështesë mobilitetin për studentët, stafin dhe kërkuesit;
- Të promovojë dhe mbështesë bashkëpunimet kërkimore ndërkombëtare dhe aktivitetet kërkimore në nivel ndërkombëtar;
- Të rrisë ndikimin e kërkimit tonë dhe të komercializimit të aktivitetëve. Të jetë sa më atraktiv për kërkuesit, profesorët, studentët dhe stafet e tjera jashtë vendit;
- Të zhvillojë dhe përmirësojë mësimdhënien ndërkombëtare;
- Të pasurojë programet me përmbajtje ndërkombëtare.

Fushat e ndërkombëtarizimit

• Skemat e bursave

Qëllimi i USH-së është të rrisë mundësitë e shkëmbimit në Evropë dhe më gjerë duke rritur numrin e studentëve që përfitojnë nga mundësitë për të studiuar jashtë vendit si pjesë e studimeve të tyre në USH. Për të rritur shkallën e pjesëmarrjes dhe për të mbështetur studentët në aktivitetet e tyre ndërkombëtare, USH është e angazhuar të pakësojë pengesat financiare për studentët që në mënyrë periodike dëshirojnë të ndjekin studimet jashtë vendit. Një sërë bursash studimore u janë ofruar studentëve dhe stafit, dhe kjo bazuar në varësi të destinacionit të studimit, nevojave financiare dhe meritës akademike.



STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT TE UNISHK 2022-2026

Universiteti i Shkodrës është pjesë e aplikimeve në projektet e shkëmbimit të stafit akademik dhe administrativ si dhe të studentëve. Këto aplikime bëhen në kuadër të projekteve Credit Mobility, KA 107 që nxisin dhe mbështesin mobilitetet e lartpërmendura.

Universiteti gjithashtu po punon për të gjetur sponsorë të jashtëm ose donatorë që ofrojnë bursa të reja studimore për studentët në mënyrë që të kenë mbështetje financiare në mobilitetin e tyre.

- **Partneritetet**

USH është e angazhuar të zhvillojë partneritete në shkallë rajonale dhe globale. Qasja jonë ndaj partneritetit është bashkëpunimi me partnerë dhe me grupe të interesit me të cilët ndajmë qëllime dhe interesa të përbashkëta. Ne kërkojmë të ndërtojmë partneritete mbi bazën e qëndrueshmërisë dhe reciprocitetit. Këto partneritete ndahen në tri fusha të rëndësishme: partneritet e mësimdhënies, partneritetet kërkimore dhe partneritetet për mobilitetin e studentëve.

- **Partneritetet e mësimdhënies**

USH inkurajon zhvillimin e partneriteteve ndërkombëtarë në mësimdhënie me institucione cilësore kudo në botë. Aktualisht USH ka shumë marrëveshje me institucione dhe partneritete aktive në mësimdhënie duke u siguruar studentëve mundësi studimi inovative dhe interesante në nivel ndërkombëtar. Ne mirëpresim nisma të tjera për bashkëpunime rajonale dhe më gjerë në fushën e mësimdhënies. Politika që ka ndjekur USH është ajo e zgjerimit të rrjetit të bashkëpunimeve me synimin e shkëmbimit të përvojave më të mira, e cila sigurisht mbetet në të njëjtën linjë me strategjinë e Universitetit. Prioritetet e bashkëpunimeve kanë qenë shkëmbimet e përvojave dhe të stafit me qëllim përmirësimin e cilësisë së kurrikulave dhe të mësimdhënies.

Procesi i ndërkombëtarizimit ballafaqon edhe me sfida, një prej të cilave është edhe gjuha në të cilën ofrohen informacionet. Në këtë mënyrë USH synon që informacionet thelbësore të sigurohen edhe në gjuhën angleze duke e konsideruar atë si një gjuhë ndërkombëtare të kërkimit. Për këtë arsye të gjitha lajmërimet, materialet informuese, faqja zyrtare e web-it të USH-së sigurohen edhe në gjuhën angleze. Në kuadër të projekteve Credit mobility KA1 është mjaft e rëndësishme që fakultetet të ofrojnë sa më shumë lëndë/module në gjuhë të huaj, kryesisht në gjuhë angleze duke u përpjekur në gjendjen e hapësirave për mbështetjen financiare të stafëve të angazhuara në mësimdhënien në gjuhë huaj. Kjo mbetet aktualisht edhe një sfidë për të ardhmen në mënyrë që të rritet numri i lëndëve / moduleve të miratuara e të ofruara në gjuhën angleze të cilat do të lehtësonin edhe më tepër procesin e ndërkombëtarizimit të Universitetit të Shkodrës.

- **Partneritetet kërkimore**

Bashkëpunimi në fushën e kërkimit shkencor është një pjesë e rëndësishme e agjendës së USH-së. Ne bashkëpunojmë me qendra të tjera kërkimore dhe të ekselencës për çështje me rëndësi rajonale dhe globale dhe jemi të angazhuar të rrisim standardet. USH ka partneritet me universitete të tjera (industri) duke i mundësuar që të jetë pjesë e projekteve kërkimore në shkallë ndërkombëtare dhe të transferojë dijet në botë.

Universiteti i Shkodrës aktualisht është pjesë e: AARC (Alps-Adriatic Rectors Conference) ku USH ka marrë edhe presidencën e kësaj konference për vitin 2021-2022; AUF (Aleanca e Universiteteve Frankofone); ACEU (Alliance of Central-Eastern European Universities) etj.



- **Partneritetet për mobilitetin e studentëve**

USH është e angazhuar të rrisë mundësitë e studimit jashtë vendit për studentët e të gjitha fakulteteve dhe departamenteve. USH njih dhe vlerëson përfitimet e mëdha nga ngritja dhe mbajtja e partneriteteve si për USH-në ashtu edhe për universitetet partnere. Këto përfitime përfshijnë: krijimin e kurseve të reja inovative me karakter ndërkombëtar; mundësinë për të zhvilluar dhe fuqizuar partneritetin kërkimor mes akademikëve; krijimin e mundësive për mobilitet të studentëve; rritjen e profilit dhe markës së USH-së dhe universiteteve partnere; mundësinë për të lëvruar fonde të reja, si p.sh., ato të Erasmus +.

Në mënyrë që të kemi një mobilitet sa më të suksesshëm të studentëve, fakulteteve të Universitetit të Shkodrës u del detyra që të përafrojnë kurrikulat e tyre sa më shumë që të jetë e mundur me ato të universiteteve perëndimore. Hartimi i këtyre kurrikulave lidhet dhe me ekselencën shkencore dhe mësimore të USH-së, e cila duhet të njihet në tregun evropian të universiteteve. Një element i rëndësishëm i mobilitetit të studentëve është fakti që programet e studimit që ofron USH të respektojnë standardet dhe kërkesat e Marrëveshjes së Bolonjës. Programet organizohen dhe vlerësohen në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Vendosja e ECTS të krediteve krijon mundësinë për të arritur standardet evropiane të Arsimit të Lartë, për të lehtësuar lëvizjen e studentëve nëpërmjet njohjes së rezultateve në nivel jouniversitar, universitar dhe pasuniversitar si dhe u krijon mundësi studentëve për njohjen e krediteve në programe të tjera të ngjashme në Evropë. Përdorimi i sistemit ECTS rrit transparencën e programeve të studimit dhe kualifikimeve universitare dhe lehtëson njohjen e studimeve dhe të diplomave. Deri tani politika për mobilitetin e studentëve është bazuar në nxitjen e studentëve që të aplikojnë për studime semestrale në universitete të huaja si dhe të ftojë studentë të huaj për të studiuar në USH. Kjo bën pjesë edhe në punën për ndërkombëtarizimin e USH-së. Për këtë USH është përpjekur të gjallërojë jetën studentore duke i krijuar lehtësira për ushtrimin e aktiviteteve brenda universitetit si dhe të nxisë lidhjet e studentëve të USH-së me studentët e universiteteve të tjera nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta. Përveç kësaj USH ka ftuar për studime të pjesshme semestrale studentë nga universitete të huaja që dëshirojnë të studiojnë në USH.

- **Kurrikula ndërkombëtare**

USH synon të jetë një institucion global. Për t'u siguruar studentëve tanë një përvojë globale, ne sigurohemi që të gjitha aspektet globale të jenë të pranishme në të gjitha fushat e jetës së USH-së. Kjo do të thotë që ne përqipemi të ofrojmë kurrikula të ngjashme me ato ndërkombëtare. Në këtë mënyrë ne sigurohemi që studentët tanë të jenë të përgatitur dhe të aftë për të qenë qytetarë globalë dhe t'u rrisim atyre mundësitë e punësimit. Për këto arsye USH është vazhdimisht e angazhuar dhe e fokusuar në: ndërkombëtarizimin e përmbajtjes së programeve dhe kurseve aktuale që USH ofron; zhvillimin e programeve me fokus ndërkombëtar; rritjen e shkathësive dhe kompetencave gjuhësore të studentëve apo aplikimin e programeve të përbashkëta si më poshtë: program studimi Master Shkencor në Jurisprudencë (Drejtësi) me Seconda Universita' di Napoli (Universiteti Vanvitelli, Napoli); program studimi në Fizioterapi me Universitetin e Padova-s; program studimi në Gareontologji (kujdesi për të moshuar) me Universitetin e Vechta-s, Gjermani, program Bachelor në Gjuhën Angleze dhe Master në Mësuesi në Gjuhë Angleze për ciklin parashkollor dhe atë të shkollës fillore (young learners) me Tokat Gaziosmanpasa University, Turqi, program Bachelor në Gjuhë të Huaja për integrim profesional me universitetin Haute –Alsace, France.



Në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, programet e nivelit BA kanë të detyruar në vitin e parë të studimit lëndën Gjuhë e Huaj, njëra nga pesë gjuhë e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht. Për rritjen e konsiderueshme të njohjes së më shumë gjuhëve të huaja, shumica e programeve përmbajnë në vitet në vijim edhe lëndën me zgjedhje Gjuhë e Huaj, me përfshirje më të gjerë ku gjuhëve të lartpërmendura i shtohen edhe gjuha malazeze dhe gjuha turke.

Një nga qëllimet e USH-së është të integrojë në kurrikulat aktuale edhe lëndë (të detyrueshme ose me zgjedhje, kjo në varësi të specifikave të kurseve studimore) me qëllim njohjen e studentëve me çështje globale, si p.sh.: kultura globale dhe shoqëria, politikat globale, shëndeti global apo dhe fusha të tjera të ngjashme.

• **Kërkimi**

Zhvillimi i kërkimit është një nga objektivat themelore të planit strategjik të Universitetit të Shkodrës, i cili është i angazhuar të ndërmarrë kërkime në nivel rajonal dhe global në bashkëpunim me institucione të tjera. Objektivi i rëndësishëm i USH-së si dhe i të gjithë studentëve që studiojnë në këtë universitet është njohja në shkallë ndërkombëtare e diplomës që i lëshohet studentit në përfundim të studimeve. Arritja e këtij objektivi është e lidhur edhe me cilësinë e mësimdhënies, nivelin e stafit akademik, nivelin e studentëve, kushteve të studimit (raportet staf akademik /student, sipërfaqe / student etj.). Plotësimi shkallë-shkallë i këtyre kushteve ofron realizimin e objektivit strategjik më të rëndësishëm në shkallën e ndërkombëtarizimit të USH-së. Zbatimi i projekteve ndërkombëtare ka ndihmuar në gjetjen e partnerëve strategjikë në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit. USH ka krijuar traditë përmes pjesëmarrjes në projektet TEMPUS (sot Erasmus +) ku ka qenë partner. Në vitet në vazhdim synohet të punohet për të hartuar projekte shkencore ku USH të ketë rol drejtues. USH synon hartimin e projekteve në kuadër të Erasmus + (KA1 dhe KA2), Horizon 2020 dhe projekte të tjera të Komunitetit Evropian. USH është e angazhuar të ndërmarrë dhe të mbështesë në rang të gjerë aktivitetet kërkimore ndërkombëtare, prandaj është punuar për të krijuar një profil kombëtar dhe ndërkombëtar të USH-së në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor duke organizuar mësimdhënien në tri nivelet e studimit.

Përmirësimi i lidhjeve ndërkombëtare lidhet ngushtësisht me angazhimin e anëtarëve të USH-së në rrjetet akademike ndërkombëtare, ku mund të përmendet anëtarësimi i tyre në GREM (Groupe de recherche euroméditerranéen-Grupi kërkimor euromesdhetar, www.flsh.uha.fr), dhe në ILLE (Institut des langues et littératures européennes - Instituti kërkimor i gjuhëve dhe letërsisë evropiane) pranë Universitetit Haute Alsace France (www.ille.uha.fr), bashkëpublikimet me kolegë ndërkombëtarë dhe me mundësinë e tyre për të publikuar studimet në revista ndërkombëtare sa më prestigjioze.

Tradicionalisht, projektet ndërkombëtare kërkimore janë realizuar me anë të përpjekjeve të stafit akademik dhe administrativ që bëjnë të gjithë punën e nevojshme dhe japin ekspertizën e tyre gjatë fazave të shkrimit dhe zbatimit të projekteve. Universiteti vlerëson angazhimin e stafit të vet në projekte dhe e konsideron këtë mjet si mjaft të fuqishëm për promovimin e reputacionit të vetë universitetit.

• **Mobiliteti i stafit akademik**

Mobilitetet synojnë forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe marrëveshjeve ekzistuese me Universitete të tjera (brenda dhe jashtë vendit), krijimin e marrëveshjeve të reja dhe



STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT TE UNISHK



ndërkombëtarizimin e Universitetit të Shkodrës. USH-ja ka qenë në lidhje të vazhdueshme me institucione homologe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacioni për zhvillimet më të reja është siguruar me ndihmën e kontakteve të profesoratit të këtij universiteti me universitete të tjera si dhe nëpërmjet veprimtarive të përbashkëta në fushën e kërkimit shkencor e të mësimdhënies. Në kuadrin e bashkëpunimit me universitetet e tjera, pedagogët e USH-së kanë marrë pjesë në veprimtari të organizuara brenda dhe jashtë vendit, duke marrë informacione të reja në fushën e mësimdhënies, të programeve mësimore si dhe të objektivave që kanë këto për të ardhmen. Rëndësi i është kushtuar edhe stafit akademik të huaj që ka ardhur në Universitetin e Shkodrës.

Universiteti i Shkodrës synon krijimin e mundësive për mobilitetin e stafit akademik nëpërmjet:

- Pjesëmarrjes në konferenca shkencore ndërkombëtare;
- Trajnimeve të përbashkëta me universitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor;
- Vizitave studimore në kuadër të shkëmbimit akademik bilateral me universitete të vendeve perëndimore;
- Mobilitetit të personelit akademik në universitete ndërkombëtare me qëllim kualifikimin e mëtejshëm të tyre.

• Raportimi

Për zbatimin e sa më sipër, përcaktohen në këtë strategji edhe strukturat përkatëse përgjegjëse. Në USH, si garanci për mbarëvajtjen e marrëveshjeve aktuale dhe marrëveshjeve të reja që do të zhvillohen në të ardhmen, Zëvendësrektori raporton çdo vit para Senatit Akademik mbi ecurinë e marrëveshjeve, projekteve aktuale dhe punën e bërë për sigurimin e marrëveshjeve dhe projekteve të reja.

• Mbështetja financiare

Prioritet i kësaj strategjie konsiderohet mbështetja nga Rektorati dhe administrata e USH-së e stafeve që janë të suksesshme me projektet, por edhe mbështetje maksimale për stafet që rishtazi përfshihen në hartimin e projekteve me financim të huaj, bazuar në prioritetet strategjike të USH-së (miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.97, datë 29.03.2021, nr.1026 prot.).



Plani i veprimit 2022-2026

Objektivat	Detyrat (përshkrimi)	Afatet kohore	Burimet dhe Personat përgjegjës
1. Rritja e numrit të projekteve ndërkombëtare.	Realizimi i një studimi lidhur me bashkëpunimin në fushën kërkimore të çdo pedagogu, departamenti, fakulteti me institucionet e huaja dhe mbi këtë bazë do të institucionalizohet ndihma dhe mbështetja financiare, në mënyrë që kjo lidhje të rritet dhe të zgjerohet në të ardhmen. Përfshirje e ekspertëve dhe profesionistëve që kanë eksperiencë në përpilimin e projekteve. Afrimi i tyre pranë zyrës së Zhvillimit dhe Marrëdhënies me Jashtë do të rrisë cilësinë e projekteve për konkurrim. Zhvillim i mekanizmave dhe mjeteve për para-financim, ose Krijimi i një "Fondi për mbështetjen e projekteve", i cili do të monitorojë faza përgatitore dhe fillestare të projekteve.	1 vit	Fakultetet +DZHMJ
		1 vit	DMZHJ, Rektori
		1 vit	Kancelari
2. Rritja e numrit të mobiliteteve të dyanshme të stafit dhe studentëve.	Rikonceptim për organizimin e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të lëvizjes së pedagogëve dhe studentëve. Ofrimi i sa më shumë programeve mësimore në gjuhë të huaj (me prioritet gjuhën angleze), pasi kjo do të mundësojë ardhjen e shumë studentëve të huaj në Universitetin tonë për ndjekjen e moduleve të ndryshme. Në fakt kjo është edhe një kërkesë kryesore në kuadër të aplikimeve të Erasmus+ (Credit Mobility). Përsa i përket Marrëveshjeve Credit Mobility (KA1) do të punohet për rinovimin dhe zgjerimin me marrëveshje të reja duke zgjeruar fushën e studimit (përgjithësisht është vetëm në fushën e ekonomisë) si dhe rritjen e mundësive të aplikimit për stafin administrativ. Sigurimi i fondeve për mobilitetin e stafit akademik drejt Universiteteve Evropiane e më gjerë në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Sigurimin e fondeve për financimin e kërkimit shkencor për stafin akademik gjë që do të kontribuonte në përmirësimin e kërkimit shkencor dhe në rritjen akademike të stafit, e cila ndihmon edhe në ndërkombëtarizimin e USH-së.	2 vite	DZHMJ+ Fakultetet
		2 vite	Zyra Kurrikulave+ Fakultetet
		2 vite	DMZHJ+ Fakultetet Rektorati +Dega e Financës +Bordi Administrativ



STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT TE UNISHK 2022-2026



<p>3. Zgjerimi i rrjetit të institucioneve partnere.</p>	<p>Krijim i partneriteteve me universitetet, organizatat kërkimore dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë, sidomos me ato të rajonit, duke theksuar marrëveshjet me universitetet shqipfolëse, me prioritet intensifikimin e shkëmbimeve të pedagogëve dhe studentëve.</p> <p>Forcim i partneriteteve strategjike me institucione në Evropë dhe më gjerë. Në mënyrë të veçantë, duke u përqendruar në dy-tre universitete, këto lidhje do të analizohen në drejtim të bashkëpunimit, shkëmbimit të dokumentacionit shkollor, sidomos përkthimit të teksteve dhe hapjen e programeve të reja të studimit për tri nivelet e shkollimit.</p> <p>Ripërcaktim në mënyrë të qartë i rrjetit ekzistues të marrëveshjeve ndërkombëtare me prioritet cilësinë dhe efektivitetin e dëshmuar me anë të bashkëpunimeve. Do të pasqyrohen në faqen zyrtare elektronike të gjitha universitetet partnere dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të hartuara. Në këtë drejtim do të rigjallërohen dhe do t'u jepet fuqi marrëveshjeve dhe programeve të shkëmbimit të pedagogëve e studentëve. Sipas programeve të ndryshme të mbështetura nga Komuniteti Evropian, si: Long life learning, ERASMUS-Plus, Credit Mobility etj.</p> <p>Rritja e numrit të konferencave dhe seminareve ndërkombëtare të organizuara në Universitetin e Shkodrës e cila do t'i jepte një dimension më të madh ndërkombëtarizimit.</p>		<p>DZHMJ dhe kanët</p> <p>DZHMJ+Fakultetet</p> <p>DZHMJ</p> <p>Fakultetet</p>
<p>4. Përmirësim i burimeve dhe të infrastrukturës për të mbështetur bashkëpunimin ndërkombëtar.</p>	<p>Sigurimi aksesit online free për stafin akademik/kërkuesit dhe studentët (për t'u njohur me të rejat e fundit në çdo fushë studimi) të USH-së në library digjitale multidisiplinore. Njohja me të rejat e fundit në fushat kërkimore përkatëse, ndihmon pedagogët të jenë më pranë kolegëve të tyre në universitetet e huaja, përsa i përket cilësisë së punimeve, duke rritur mundësinë për publikime kërkimore-shkencore në revista apo konferenca ndërkombëtare me faktor impakti të konsiderueshëm.</p>	<p>3 vite</p>	<p>IT+DMZHJ+ Fakultetet</p>
<p>5. Përdorimi më efikas i Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit për të lehtësuar ndërkombëtarizimin e USH-së.</p>	<p>Përkthim i Buletineve shkencore në gjuhën angleze, dhe publikim i përkthimeve në website të USH-së.</p> <p>Implementim të tools-ve ICT si:</p> <ul style="list-style-type: none"> --e-learning: për menaxhimin e kurseve online nëpërmjet LMS si MOOCs, WebCt, GoogleSite etj., (ku të gjithë pedagogët efektivë pa-përrjashtim të përdorin të njëjtin sistem duke krijuar nga një profil user-i për secilin). --m-learning (mobile-learning duke përdorur aplikacione në pajisjet smartphone). --video-konferenca (një mundësi për t'i ofruar studentëve të jenë pjesë e ligjëratave nga pedagogë të ftuar, ekspertë në fusha të ndryshme jashtë vendit). 	<p>1 vit</p> <p>3 vite</p> <p>2 vite</p>	<p>DMZH+IT</p> <p>DMZHJ+IT</p> <p>IT+Fakultetet</p>



Ankesi Nr 1. Lista e projekteve ndërkombëtare të zhvilluara në USH.

Projekte të përfunduara:

- Projekti “Developing teacher competencies for a comprehensive VET system in Albania (Zhvillimi i Kompetencave të Mësuesve për një Sistem Gjithëpërfshirës të ATP-së, (Arsim & Trajnim Profesional) Teavet.
- (Nxitja e sistemit të inovacionit të turizmit në rajonin Adriatikut - Jonit) INTERREG ADRION "FOST INNO.
- Safe Harbor – An EU Operation To Tackle Gaps In Cross-Border Cooperation Of Training Providers me kod JUST-JTRA-EJTR-AG-2017.
- Projekti HELIX
- Projekti “Drejt rritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësisë dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale” T@sk, numër 585626-EPP-1-2017-1-IT-EPPKA2-CBHE-JP, Marrëveshje numër 2017 – 2881 / 001 – 001.

Projekte në proces:

- Virtual Albanian European Universities Exchange -VALEU-X, Nr: 2019 - 1976/001 – 001, 610360-EPP-1-2019-1-DE-EPPKA2-CBHE-JP;
- Improving REsearch capacities of Albanian higher education institutions in conservation and restoration of Cultural Heritage 610390-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA2-CBHE-SP – REACH;
- Sustainable University - Enterprise Cooperation for Improving Graduate Employability (SUCCESS). 618975-EPP-1-2020-1-BA-EPPKA2-CBHE-JP; 01-230-1/2020;
- Entrepreneurial skills for a Modern Education in Albania, EntrAL; 617886-EPP-1-2020-1-FI-EPPKA2-CBHE-SP;
- “Inclusive tertiary Education in Western Balkans – IDEA” Capacity – Development in pursuit of Equity and Accessibility of HEIs in the Wester Balkans for Students with Disabilities and/or Learning Difficulties”; 618859- EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP;
- MSc. Course in STEAM education – STEAMedu; 618996-EPP-1-2020-1-BA-EPPKA2-CBHE-JP;
- "University to Society Infomediaries in Albania: Co-Production of knowledge and research that matters" / U-SIA; 618997-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP;
- “Vlerësimi i ndikimeve të ndërsjellta ndërmjet ndryshimeve klimaterike dhe ndotjes së ajrit, mbi territorin e Shqipërisë”, AKSHI;
- “Krijimi i një Programi studimi në Gjuhë të huaja të aplikuara; Gjuhë frënge, italiane dhe gjermane për Turizmin” AUF;
- Reformimi i studimeve doktorale në Mal të Zi dhe Shqipëri – Paradigma e praktikës së mirë, akronimi i projektit MARDS 598465-EPP-1-2018-1-ME-EPPKA2-CBHE-SP (2018 – 2479/ 001-001).



Aneksi Nr 2. Lista e Universiteteve në kuadër të marrëveshjeve të Credit Mobility (KA1)

- Universiteti i Varnës (Bullgari);
- Universiteti i Krakovit (Poloni);
- Universiteti i Varshavës (Poloni);
- Universiteti i Almerias (Spanjë);
- Universiteti i Complutense (Spanjë);
- Universiteti i Jean, (Spanjë);
- Universiteti i Vechta (Gjermani);
- Universiteti i Foro Italico (Itali);
- Universiteti i Bolgna (Itali);
- Universiteti i Pragës (Republika Çeke);
- Universiteti i Ostravës (Republika Çeke);
- Universiteti i Kamerinos (Itali);
- Seconda Universita degli Studi di Napoli (Itali);
- Universiteti i Vidzeme (Letoni);
- Universiteti i Carinthis (Austri);
- Universiteti i ISAG (Protugali);
- Universiteti i Mesinës (Itali);
- Universiteti i Pitestit (Rumani);
- Universiteti i Sapiencës (Itali);
- Universiteti i Zagrebit (Koraci).



Aneksi 3. Marrëveshjet bilaterale të Universitetit të Shkodrës me Universitetet Evropiane dhe Shqipërisë SHKODË

Universiteti	Nënshkrimi	Vlefshmëria
Vidzeme University of Applied Sciences, Latvia	15.01.2016	5 vite
Uni.of Information Science and Technology "St. Paul the Apostle" Macedonia	04.04.2016	Pa limit
Scuole Civiche di Milano	Prill 2016	Pa limit
OPOLE University of Technology, Poland	10.10.2016	5 vite
Universita del Piemonte Orientale, UPO	20.10.2016	5 vite
Istituto Universitario di Studi Europei	11.01.2016	Pa limit
Shoqata "Geroge C. Marshall", Shqipëri	29.06.2016	Pa limit
Seconda Università di Napoli, Italy	15.01.2016	3 vite
Universiteti "Marin Barleti"	27.03.2017	Pa limit
Universiteti Albanian University	2017	Pa limit
Sapienza Università di Roma	16.06.2017	5 vite
Kyiv National Linguistic University, Ukrainë	17.11.2017	3 vite
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Kosovë	02.05.2017	3 vite
Shoqata Kosovare per Psikodagnostike dhe Psikoterapi	2017	
Acharya Nagartuna University, India	06.07.2017	Pa limit
Kolegji Universitar "Luarasi"	10.02.2017	Pa limit
Muzeu "Marubi"	2017	2 vite
Universiteti "UkshinHoti", Prizren	22.09.2017; Rinovuar 08.03.2020	Pa limit
Faculty of Philology, Montenegro	12.06.2018	Pa limit
Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani"	29.10.2018	1 vit
Sandhills Community College, Pinehurst, North Carolina	08.05.2018	5 vite
Universita Politecnica delle Marche	01.10.2018	1 vit
Marrëveshje operative ACLI (IPSIA)	21.05.2018	3 vite
Univesiteti i Mjekësisë, Tiranë	01.03.2018	4 vite
University of Mostar, Bosnia-Hercegovina	02.2018	Rishikim cdi vit
ACLI, Ipsia	21.5.2018	3 vite
Trakya University, Edime, Turkey	23.10.2018	5 vite
Sherbimi i Provës, Zyra Vendore, Shkodër	19.11.2018	Rinovimcdo vit
Popovo, Kula, Winery, JSC:Macedonia	31.5.2018	5 vite
Kuvendi i Shqipërisë	31.10.2018	Rinovimautomatikisht
Organizata Shqiptare e Urdhrit të Maltës	28.09.2018	Pa limit
Gjykata e Rrethit Shkodër	16.11.2018	Rinovimcdo vit
Muzeu Historik, Shkodër	16.11.2018	5 vite
Universite de Haute-Alsace, Francë	01.04.2019	5 vite



STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT TE UNISHK

2022-2026

Universiteti i Firences	Rinovuar 21.01.2019	7 vite
Universiteti "Aleksander Moisiu", Durrës	26.02.2019	Pa limit
University of Zagreb	14.05.2019	5 vite
Trakya University, Edime Turkey	11. 07. 2019	5 vite
University of Opole, Poland	03.06.2019	5 vite
Oda e Infermiereve, Mamive, Kosovë, OIK	2019	Pa limit
IBIS Memorandum bashkëpunimi (Confcommercio) Lazio	14.10.2019	2 vite
European Center Maribor, Maribor, Slloveni	08.07.2019	5 vite
Carinthia University of Applied Sciences, Austria	05.08.2019	5 vite
Universiteti i Vlores "Ismail Qemali"	03.12.2019	Pa limit
Akademia e studimeve Albanologjike	10.10.2019	Pa limit
Universiteti Metropolitan i Tiranës	16.04.2020	5 vite
M.M.C Consulting Srl	18.05.2020	Rishikim çdo vit
Federata Shqiptare e Sportit Universitar, Tiranë (anëtarësim)	29.09.2020	Pa limit
Universita LUM (Jean Monet) Itali	07.07.2020	5 vite
Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"	23.10.2020	
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë	30.10.2020	3 vite
Universiteti Metropolitan i Tiranës	16.04.2020	5 vite
M.M.C Consulting Srl	18.05.2020	Rishikim çdo vit
Federata Shqiptare e Sportit Universitar, Tiranë (anëtarësim)	29.09.2020	Pa limit
Universita LUM (Jean Monet) Itali	07.07.2020	5 vite
Universiteti i Gjakoves "Fehmi Agani"	23.10.2020	
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë	30.10.2020	3 vite
Alternativa Pro	10.11.2020	Pa limit
Operatori i Shërbime të Kujdesit Shëndetësor	12.11.2020	Pa limit
Qendra e testimit S.T.A	20.11.2020	5 vite
Qendra e studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët	16.04.2021	3 vite
Universiteti i Arteve, Tiranë	26.05.2021	Vit pas viti
Qendra Shëndetësore, Tirol, Austri	08.07.2021	5 vite
Universiteti "Haxhi Zeka", Pejë, Kosovë	29.07.2021	Pa limit

Grupi i punës:

Eliana Laçe

Elvira Drishti

Emanuela Furramani

Rrezearta Draçini

Visar Dizdari





STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT TE UNISHK ²⁰²²⁻²⁰²⁶

